



AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

Ex officio nr. 146/2021

Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes





Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

Ex officio nr. 146/2021

Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes

Drejtuar:

Z. Glauk KONJUFCA, Kryetar
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Z. Albin KURTI, Kryeministër
Qeveria e Kosovës

Znj. Arbërie NAGAVCI, Ministre
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Z. Kreshnik RADONIQI, Kryesues
Komisioni Qendror Zgjedhor

Z. Enver FEJZULLAHU, Drejtor Ekzekutiv
Akademia e Drejtësisë

Z. Jeton MEHMETI, Kryetar
Komisionit të Pavarur për Media

Z. Behar EJUPI, Kryetar
Oda e Avokatëve të Kosovës

Prishtinë, më 15 janar 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara: Institucioni i Avokatit të Popullit, Kosovë

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

Ky raport u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, përmes projektit "Lufta kundër diskriminimit dhe urrejtjes", që është pjesë e programit të përbashkët "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë". Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Raport synon ta pasqyrojë gjendjen gjuhës së përdorur në diskursin e komunikimit publik në Kosovë. Raporti bazohet në monitorimin, hulumtimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura nga seancat parlamentare, debatet televizive dhe komentet në mediat sociale, për periudhën kohore nga viti 2020 deri në vitin 2022.

Dizajni i grupeve të të dhënave dhe zgjedhja e kornizës kohore u përcaktua nga qëllimi përfundimtar i hulumtimit: *ofrimi jo vetëm i një pasqyre të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse mbi instancat dhe grupet e ndryshme të cilat mund të jenë cak i gjuhës së urrejtjes në diskursin publik në Kosovë, por edhe i nxitësve të mundshëm të urrejtjes (me apo pa qëllim).*

Metodologjia e hulumtimit është bazuar në standardet ligjore ndërkombëtare dhe vendore. Raporti jep një pasqyrë të analizës së diskursit publik e mediatic, duke ndërthurur qasje sasiore dhe cilësore, pas shqyrtimit të transkriptove të: 8 seancave parlamentare (janar 2022– mars 2022); 23 emisione debatesh televizive të transmetuara online; 4 platforma të mediave sociale; 43.511 komente dhe 313 postime lajmesh në rrjetet sociale. Hulumtimi ka gjetur modele të përsëritura, siç janë arsyet dhe caqet e gjuhës së përdorur (besimi politik dhe përkatësia politike; përkatësia etnike; feja; seksi, gjinia dhe orientimi seksual), forma të shprehjes (kërcënime dhe mallkime; fyerje në baza racore dhe etnike; metafora çnjerëzore); si dhe diskursi mediatic që shkakton edhe komente urrejtjeje nga përdoruesit e mediave sociale; mungesa e moderimit në media që ekspozojnë opinionin publik ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes

Vëmendje i është kushtuar edhe diskursit retorik dhe gjuhës së përdoruar ndaj personave LGBTI, ndikimin e diskursit publik, agjendës në mediumet kryesore dhe atyre sociale, si dhe reagimet e opinionit publik ndaj tyre. Të dhënat janë analizuar si manualisht, me një qasje cilësore, ashtu edhe automatikisht, nëpërmjet Sketchengine¹ dhe Crowdtangle², me synimin për të studiuar gjuhën e përdorur përmes kërkimit të koleksioneve të mëdha tekstesh sipas pyetjeve të motivuara gjuhësisht, pra fjalëve kyçe ose shprehjeve kyçe. Crowdtangle është një mjet publik i njohurive nga Meta që lejon përdoruesit të analizojnë tendencat e Facebook dhe të matin performancën e postimeve.

Ndër të tjera, ky raport, ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes për ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve lidhur me standardet ndërkombëtare dhe vendore, me të drejtën e lirisë së shprehjes, si dhe me konceptin e gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, ka për qëllim të kontribuojë në kuptimin e modeleve të diskursit të gjuhës së përdorur në mediet sociale dhe komunikimin publik në vend, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, fyese e retorike që përfshin mospajtime me ide apo mendime të caktuara, sfidimin e ideve apo besimeve, retorikë që përfshinë veprime negative jo të dhunshme apo karakterizime dhe ofendime dhe specifikime të karakterizimeve çnjerëzore të individit apo grupit/ eve të prekur/a, si edhe të rrisë aftësinë e shoqërisë për të reaguar dhe për të zhvilluar narrativë që promovon të drejtat e njeriut, diversitetin dhe tolerancën.

Raporti jep shembuj të mbledhur nga hulumtimi lidhur me gjuhën e përdorur në diskursin publik, me fokus në emisione televizive dhe parlamentin e vendit e që nxisin debat edhe në **mediat sociale**.

¹ është softuer për analizimin e tekstit, i zhvilluar nga Lexical Computing Limited, www.sketchengine.co.uk.

² <https://www.crowdtangle.com/>.

HYRJE



*Ekziston një vijë e hollë midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes.
Fjala e lirë e inkurajon debatin, ndërsa gjuha e urrejtjes nxit dhunën.*

Newton Lee³

Çështja e lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, paraqesin çështje komplekse për sa i përket mënyrës se si autoritetet shtetërore mund dhe duhet të ekuilibrojnë përgjegjësinë e tyre për të reaguar me shpejtësi dhe efektivitet në rastet kur identifikohet se një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime. Gjuha e urrejtjes në diskursin publik, në përgjithësi në Evropë, është theksuar më shumë në kohën e pandemisë Covid- 19 dhe ngre nevojën për punë të pandërprerë në monitorimin, parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe format tjera të shprehjes si në internet dhe jashtë tij⁴. Puna e pandërprerë në këtë kuptim ngërthen në vete një sërë veprimesh dhe aktiviteteve, duke nisur nga fushatat vetëdijesuese në institucionet parashkollore e tutje, efikasiteti i reagimit nga organet e drejtësisë si dhe në varf veprimesh e masa konkrete në luftën kundër diskriminimit në cilën do baze, e të gjitha këto veprime e masa do të duhej ndërmarrën nga institucionet publike në partneritet dhe koordinim me shoqëria civile në vend.

Është e rëndësishme të theksohet ndjeshmëria dhe sfida komplekse që paraqet vendosja e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes, si e drejtë themelore në çdo shoqëri demokratike, si dhe përcaktimit të kufijve të saj në raport me të drejtat e tjera. Vendosja e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes dhe kufijve të saj paraqet sfida të vazhdueshme edhe në institucionet me të larta ndërkombëtare siç është edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ). Megjithatë, përcaktimet në dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe sidomos jurisprudenca e GjEDNJ kanë ndërtuar një standard mbi garantimin e lirisë së shprehjes dhe përcaktimin e kufijve të nevojshëm.⁵

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ), në nenin e 10 të saj, e përcakton mbrojtjen e lirisë së shprehjes, lirisë së mendimit dhe shprehjes së qëndrimit (paragrafi 1), por përcaktohen edhe kushtet për kufizimin e saj (paragrafi 2). Pra, liria e shprehjes si koncept nënkupton një kornizë më të gjerë të të drejtave që përfshinë brenda saj, siç janë: liria për mbajtjen e opinionëve pa ndërhyrje (liria e opinionit), liria për të kërkuar, marrë dhe ndarë informatat dhe idetë (gojarisht, me shkrim, në formë të artit, përmes medieeve, përfshin jo vetëm përmbajtjen, por edhe mjetet e shprehjes. etj.⁶). Liria e shprehjes është liria e të gjithëve për t'u shprehur, është e drejta për të folur, për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në jetën politike, artistike dhe shoqërore.

³ Speak Peace! Hate speech is not an option! Shih në <https://shorturl.at/arG47>, f.7

⁴ KERI, Raporti vjetor mbi aktivitetet e KERI-t, që mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2017, <https://rm.coe.int/annual-report-on-ecri-s-activities-covering-the-period-from-1-january-/16808c168b>.

⁵ Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit të Kosovës, Ex officio 707/2017, lidhur me lirinë e shprehjes (medieeve) dhe sigurinë e gazetarëve, shih në <https://bit.ly/3RL8gDR>

⁶ Raport i Avokatit të Popullit Ex officio nr.707/2017, 2 nëntor 2017, para.24, fq.5., shih në: <https://oik-rks.org/2017/11/02/raport-ex-officio-lidhur-me-lirine-e-shprehjes-dhe-sigurine-e-gazetareve/>

Neni 10 i KEDNj

1. *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.*
2. *Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

Paragrafi 2 i nenit 10, i përcakton rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Kryesisht kërkohet nga Shtetet të mos ndërhyjnë në ushtrimin e të drejtave.⁷ Ajo që i dallon detyrimet pozitive nga ato negative është se të parat kërkojnë një ndërhyrje pozitive nga Shteti, ndërsa të dytat kërkojnë që shteti të mos ndërhyjë.

Pra, paragrafi 2 i nenit 10 të KEDNj, nënkupton sistemin e kufizimeve në ushtrimin e të drejtës për lirinë e shprehjes.⁸ Nëpërmjet nenit 10 paragrafi 2, KEDNj konfirmon se realizimi i lirisë së shprehjes përfshin edhe përgjegjësi dhe obligime dhe mund vetëm në rrethana të rrepta, të kufizohet ose sanksionohet nëse kushtet e rrepta paraqesin masa të domosdoshme për sigurinë shtetërore integritetin territorial dhe sigurinë publike, ruajtjen e rendit dhe parandalimin e parregullsive dhe krimeve, mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, si dhe kufizimin e përhapjes së informatave konfidenciale ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit.⁹

Në vlerësimin se a është legjitim ose jo kufizimi i lirisë së shprehjes nga ana e shtetit, GjEDNj këtë e përcakton edhe përmes kriterëve të parashikuara në nenin 10, paragrafin 2, të cilat doemos duhet të respektohen: *të jetë i përcaktuar me ligj; të ketë qëllimi legjitim; të jetë e domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale me qëllimin e ndjekur.*¹⁰

Liria e shprehjes, në kontekstin e saj, mundëson shkëmbim idesh dhe pluralizëm që të realizohet pasuria e mendimit dhe përmes komunikimit të realizohet demokracia dhe diskursi politik. Prandaj edhe kufizimet e saj duhet të kalojnë përmes një filtri të rreptë me qëllim që e njëjta të mos rrezikohet apo abuzohet. Gjatë shqyrtimit të rasteve të kufizimit të lirisë së shprehjes mund të identifikohen raste kur një shprehje e caktuar mund t’u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime. Ky mekanizëm mundëson që të mos abuzohet liria e shprehjes dhe të mos orientohet drejt të kundërtës së plotë të kësaj lirie, siç është gjuha e urrejtjes e cila është abuzimi më serioz i mundësisë së shprehjes¹¹.

⁷ Detyrimet pozitive sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Udhërrëfyes për përdorimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Manuali e të Drejtave të Njeriut Nr. 7, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut Këshilli i Evropë, shih në: <https://rm.coe.int/handbook-7/16806fc13f>, (07/03/2023)

⁸ Liria e Shprehjes, Një Udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut, Nr.2, shih në : [handbook-2.indd\(coe.int\)](https://handbook-2.indd(coe.int)), (07/03/2023)

⁹ Elena Mihajlova, Jasna Bačovska, Tome Shekerxhiev. Liria e Shprehjes dhe Gjuha e Urrejtjes, - Skopje: OSBE, 2013. Shih në <https://www.osce.org/files/f/documents/0/1/116609.pdf> (07/03/2023)

¹⁰ Po aty, faqe 4.

¹¹ Po aty, faqe 23.

Koncepti i gjuhës së urrejtjes

Kompleksiteti i kësaj tematike, shtron nevojën për trajtim të balancuar dhe me shumë kujdes në parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe në garantimin e të drejtave tjera të njeriut.

Një mendim unik dhe përgjithësisht i pranuar për përkufizimin e gjuhës së urrejtjes nuk ekziston, megjithatë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj gjuhën e urrejtjes përcakton si "...të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë dhe arsyetojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin apo format e tjera të urrejtjes në bazë të jotolerancës...", ndërsa Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) i përcakton format e gjuhës së urrejtjes kështu: " të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal real ose të atribuuar si raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual".

Përkundër mungesës së një përkufizimi unik dhe të pranuar nga të gjithë, hasim në dy elemente që e dallojnë gjuhën e urrejtjes:

- *Shenjëstrimi i një grupi apo individ i pjesëtar i grupit të caktuar në bazë të tipareve fizike, shoqërore e kulturore kundër të cilit drejtohet ajo gjuhë*
- *Prania e një shkakut përcaktues që e karakterizon një grup të synuar si: raca, feja, etnia, shtetësia, orientimi seksual, gjinia dhe baza të tjera të mbrojtura, me përmbajtje që shpreh urrejtje, qëllimi për të lënduar ose ofenduar, si dhe natyra publike e gjuhës*

Plani i Veprimit të Rabatit¹², ndihmon në përcaktimin e kufijve të lirisë së shprehjes, duke vlerësuar secilin rast veç e veç në meritat e tij dhe duke pasur parasysh :1) *Kontekstin social dhe politik*, 2) *Statusin e folësit*, 3) *Qëllimin*, 4) *Përmbajtja dhe forma e gjuhës*, 5) *shtrirja e përhapjes së saj*, 6) *gjasat e dëmit, përfshirë afërsinë*.

Po ashtu, është e nevojshme që të vlerësohet edhe nga perspektiva e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nëse kufizimet e lirisë së shprehjes janë përcaktuara me ligj, ndjekin një qëllim legjitim¹³ si dhe nëse janë të nevojshme dhe proporcionale për qëllimin e ndjekur.¹⁴ Liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të justifikuar gjuhën e urrejtjes. Diskurset, të cilat mund të jenë ofenduese duhet të dallohen nga gjuha e urrejtjes. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e ka përshkruar "gjuhën e urrejtjes" si "forma të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes në bazë të intolerancës."¹⁵

¹² Plani i Veprimit të Rabatit, i qasshëm në: https://www.ohchr.org/sites/default/files/Rabat_draft_outcome.pdf

¹³ Sigurinë kombëtare, integritetin territorial, sigurinë publike, ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit, mbrojtjen e shëndetit, moralit, reputacionit ose të drejtat e të tjerëve, ndalimin e zbulimit të informacioneve konfidenciale dhe garantimin e paanshmërisë së gjyqësorit.

¹⁴ GJEDNJ, Liria e shprehjes, Udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/handbook-2/16806fc139>

¹⁵ Shih Rekomandimin Nr. R(97)20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me "gjuhën e urrejtjes", 30 tetor 1997, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/1680505d5b>

Pra, gjuha e urrejtjes lidhet ngushtë me diskriminimin, si një shprehje drejtuar një grupi apo individ, i cili ka një karakteristikë që përfshihet në bazat që mbrohen në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi. Në shumë raste, gjuha e urrejtjes është një formë e diskriminimit, dhe në këto raste duhet të vijë në shprehje detyrimi pozitiv i shtetit për parandalimin e saj me qëllim mbrojtjen e të drejtës për trajtim të barabartë e pa diskriminim.

Çështja e gjuhës së urrejtjes është trajtuar gjerësisht në një numër konventash dhe dokumentesh, të tilla si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Komiteti i të Drejtave të Njeriut (KDNJ) – Komenti i Përgjithshëm Nr.34, Plani i Veprimit i Rabatit, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KNEDR), Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KEDR) – Komenti i Përgjithshëm Nr.35, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila ka trajtuar një sërë çështjesh përmes një qasjeje kontekstuale dhe më pragmatike, si dhe Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) nr. 15 mbi Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes¹⁶.

Megjithatë, përkufizimet dhe interpretimet e ndryshme të ofruara nga këto dokumente nuk janë përkthyer në një përkufizim të qëndrueshëm dhe (të pranuar universalisht) operacional, por i vetmi supozim i përbashkët në lidhje me gjuhën e urrejtjes është se ajo mund t'i referohet:

“ të gjitha sjelljeve të cilat publikisht nxisin dhunë ose urrejtje drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë në bazë të racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike”¹⁷.

Nga pikëpamja juridike, ajo që përgjithësisht është konsideruar si thelbësore që një shprehje të cilësohet si shembull i gjuhës së urrejtjes është nxitja e saj e qartë dhe publike për dhunë dhe urrejtje kundër një grupi ose individ me karakteristika të mbrojtura. Por një përkufizim i tillë konciz lë jashtë një sasi të madhe shprehjesh dhe materialesh që mund të mos jenë ligjërisht të dënueshme, por që mund të jenë fyese e të dëmshme dhe të” helmojnë” diskursin publik dhe të nxisin dhunë, urrejtje e diskriminim.

Në *Strategjinë dhe planin e saj të veprimeve për gjuhën e urrejtjes*, OKB-ja përdorë këtë përkufizim:

“Termi gjuhë e urrejtjes kuptohet si çdo lloj komunikimi në të folur, në të shkruar ose sjellje, që sulmon ose përdor gjuhë poshtëruese ose diskriminuese në lidhje me një person ose një grup në bazë të asaj se kush janë, me fjalë të tjera, bazuar në fenë e tyre, etninë, kombësinë, racën, ngjyrën, prejardhjen, gjininë ose faktor tjetër identiteti. Kjo shpesh është e rrënjësor dhe gjeneron jotolerancë dhe urrejtje, e në kontekste të caktuara mund të jetë poshtëruese dhe përçarëse”¹⁸.

¹⁶ Shih KERI, *Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes* (miratuar më 8 dhjetor 2015), <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no.15>

¹⁷ Këshilli i Bashkimit Evropian, *Vendimi kuadër i Këshillit 2008/913/JHA i 28 nëntorit 2008 për luftimin e disa formave dhe shprehjeve të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal*, nen. 1a (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32008F0913&from=en>).

¹⁸ Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Strategjia dhe plani i saj i veprimit për gjuhën e urrejtjes*, f. 2, ([UN Strategy and Plan of Action on Hate Speech 18 June SYNOPSIS.pdf](#)).

Përkufizimi i përfshirë në Rekomandimin e ri CM/Rec (2022)16 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi luftën kundër gjuhës së urrejtjes të miratuar më 20 maj 2022, me të cilin duhet kuptuar gjuha e urrejtjes si:

“Të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal ose të atribuuar si “raca”, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, moshë, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual”¹⁹.

Duke pasur parasysh natyrën e shumë-anshme të gjuhës së urrejtjes dhe efektet e saj në objektivin(et) e saj dhe, në përgjithësi, në shoqëri, në *Preambulë* (Rekomandimi CM/Rec (2022)16 i Komitetit të Ministrave) theksi i Rekomandimit është vënë në ashpërsinë e shprehjeve të urrejtjes, dëmit që ato shkaktojnë dhe ndikimit të tyre tek anëtarët e grupeve të veçanta në kontekste të ndryshme, në mënyrë që të sigurohet që një sërë masash të kalibruara siç duhet ekzistojnë për të parandaluar dhe luftuar efektivisht gjuhën e urrejtjes, në nivele të ndryshme.

Një qasje e tillë, e harmonizuar plotësisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të përmendur tashmë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jo rastësisht bën dallimin midis tri niveleve të gjuhës së urrejtjes:

- a.** *gjuhës së urrejtjes si vepër penale*
- b.** *gjuhës së urrejtjes që nuk cilësohet si vepër penale, por që mund të jete objekt i procedurave civile dhe administrative;*
- c.** *llojet fyese ose të dëmshme të shprehjes, të cilat nuk janë mjaftueshëm të rënda për t’u kufizuar në mënyrë legjitime sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por megjithatë kërkojnë përgjigje alternative, siç përcaktohet më poshtë, si: kundër-gjuha dhe kundërmasa të tjera; masat që nxisin dialogun dhe mirëkuptimin ndërkulturor, duke përfshirë median dhe mediat sociale; dhe aktivitetet përkatëse edukative, të shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit.*

Duke vepruar kështu, *Preambula*²⁰ trajton natyrën shumëformëshe të gjuhës së urrejtjes dhe shumëllojshmërinë e shprehjeve dhe manifestimeve të saj, të cilat në shumë raste nuk mund të jenë as ligjërisht të dënueshme dhe as të qarta. Jo rastësisht, një numër në rritje i literaturës së ditëve të sotme këmbëngul se ekspliciteti nuk mund të jetë i vetmi kriter përcaktues në identifikimin e gjuhës së urrejtjes.²¹ Sipas hulumtimit, rastet e gjuhës së urrejtjes që janë hasur në seanca parlamentare, nuk thonë thjesht se dikush duhet të urrehet, por gjithashtu ofron në mënyrë thelbësore një arsytim themelor në mbështetje të urrejtjes së supozuar diskriminuese.

Ky pretendim do të vërtetohej më tej duke konstatuar se gjuha e urrejtjes “nuk manifestohet domosdoshmërisht përmes shprehjeve të “urrejtjes” [dhe për rrjedhojë] mund të fshihet në deklarata që në shikim të parë mund të duken të arsyeshme ose normale”²²

¹⁹ Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/Rec(2022)16[1] i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes* (https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=0900001680a67955).

²⁰ Rekomandimin e ri CM/Rec (2022)16 të Komitetit të Ministrave <https://shorturl.at/lmp89>

²¹ Shih për shembull Assimakopoulos S., *Nxitja e urrejtjes, ilokucionit dhe perllokucionit diskriminues*, “Pragmatika dhe Shoqëria” 11 (2), 2022, f. 177-195; Faloppa F., #Odio. *Manual i rezistencës ndaj dhunës së fjalëve*, UTET, 2020.

²² Shih Weber A., *Manuali i gjuhës së urrejtjes*, Këshilli i Evropës, 2009, f. 5.

Gjuha e urrejtjes në fakt mund të shprehet, verbalizohet dhe shpërndahe në *forma delikate* që:

- a. nuk nxit në mënyrë eksplicite dhe publike urrejtje dhe agresion
- b. duket të jetë *racionale dhe normale* dhe mund të bëhet edhe më i dëmshëm duke normalizuar këndvështrimin përkatës në debatet publike, duke desensibilizuar opinionin publik ndaj urrejtjes diskriminuese.²³

Nga një këndvështrim analitik, pranimi i ekzistencës së manifestimeve delikate të gjuhës së urrejtjes që nuk arrijnë pragjet e dënueshme, gjithashtu nënkupton dallimin e dy llojeve të gjuhës së urrejtjes, sipas një perspektive të kohëve të fundit kritike dhe analitike e diskursit:

“Nga njëra anë, ekziston ajo që mund të quhet gjuhë e ashpër e urrejtjes, e cila përfshin forma të dënueshme që janë të ndaluara me ligj, dhe nga ana tjetër, ekziston një gjuhë e butë e urrejtjes, e cila është e ligjshme, por që ngre shqetësime serioze për sa i përket intolerancës dhe diskriminimit”²⁴.

Nëse gjuha e ashpër e urrejtjes mund të identifikohet në një farë mase (më) lehtësisht për nxitjen e qartë të urrejtjes, për praninë e kërcënimeve, fyerjeve nënçmuese, shpifjeve, “fjalëve të urrejtjes” dhe të dhëna metagjuhësore (të tilla si folja *urrej*: “Unë urrej/ne urrejmë etj.”), gjuha e butë e urrejtjes mund të shkoqitet nga një grup më i gjerë diskursesh diskriminuese që mund të qarkullojnë në sferën publike dhe që janë shqyrtuar gjerësisht nga një perspektivë kritike dhe analitike e diskursit²⁵. Për shembull, gjuha e butë e urrejtjes mund të shfaqet në thëniet diskriminuese ndaj emigrantëve (edhe pse jo në mënyrë eksplicite urrejtjeje), mekanizmat “tjetri”²⁶ teknikat për të çnjerëzuar kategori të veçanta njerëzish (si pakicat etnike, të huajt, çifutët, LGBTI, etj.), metaforat konceptuale (fluks, valë, murtajë, sëmundje, etj.), implikimet dhe supozimet, heshtja dhe fshehja, etj.

Fuqia (dhe përhapja) e gjuhës së butë të urrejtjes mund të qëndrojë gjithashtu në argumentueshmërinë e saj, d.m.th., diskursi potencial i brendshëm që në mënyrë implicite shkakton lëvizje argumentuese në dyshet *qëndrim-argument*²⁷, të cilat përfundojnë duke e justifikuar dhe për rrjedhojë, e normalizon urrejtjen. Sipas Amossy, diskursi “gjithmonë i përgjigjet një pyetjeje eksplicite ose të fshehur ose të

²³ Shih Soral W., Bilewicz M., Winiewski M., *Ekspozimi ndaj gjuhës së urrejtjes rrit paragjykimet përmes desensibilizimit, “Sjellja agresive”,* 44 (2), 2018, f. 136-146.

²⁴ Shih Assimakopoulos S., Baider F., Millar S., *Gjuha e urrejtjes në internet në Bashkimin Evropian*, cit. f. 4.

²⁵ Shih për shembull Reisigl M., Wodak R., *Diskursi dhe diskriminimi: Retorika e racizmit dhe antisemitizmit*, Routledge, 2001; Richardson J., *(Keq)Përfaqësimi i Islamit Racizmi dhe retorika e gazetave britanike*, John Benjamins, 2004; Baker P., Gabrielatos C., Mcenery T., *Skicimi i muslimanëve: Analizë e drejtuar nga korpusi i përfaqësimeve rreth fjalës 'mysliman' në shtypin britanik 1998–2009*. “Gjuhësi e aplikuar”, 34 (3), 2013, f. 255–278; Breazu P., Machin D., *Racizmi ndaj romëve përmes mundësive të Facebook-ut: lidhje, të qeshura dhe inat*. “Diskursi dhe shoqëria”, 30 (4), 2019, f. 376–394.

²⁶ Tjetri: ky është një term i gjerë që përfshin shumë shprehje të paragjykimeve në bazë të identiteteve të grupit. Ai gjithashtu ofron një kornizë sqaruese që zbulon një sërë procesesh dhe kushtesh të përbashkëta që përhapin pabarazinë dhe marginalitetin e bazuar në grup. Në fakt, të tjerat mund të përkufizohen si një grup dinamikash, procesesh dhe strukturash që sjellin marginalitet dhe pabarazi të vazhdueshme në çdo gamë të plotë të dallimeve njerëzore bazuar në identitetet e grupit. Nëpërmjet këtyre dinamikave, proceseve dhe strukturave njerëzimit mund: 1) të kategorizohen sipas dallimeve të perceptuara, si përkatësia etnike, ngjyra e lëkurës, feja, gjinia ose orientimi seksual, etj.; 2) të identifikuar si inferiorë dhe të tjetërsuar nga opozita “ne, kundër tyre”. Të tjerat gjithashtu përfshijnë zhvleftësimin/neglizhimin në një ndryshim dhe përdorimin e atij ndryshimi për të çmontuar një ndjenjë ngjashmërie ose lidhjeje midis njerëzve. Më në fund krijon terrenin për diskriminim ose persekutim duke reduktuar ndjeshmërinë dhe duke parandaluar dialogun e vërtetë.

²⁷ Amossy R., *Trashëgimia e retorikës së re. Argumentimi dhe analiza e diskursit, “Argumentimi”,* 23 (3), 2009, f. 313-324; Reisigl M., Wodak R., *Qasja historike e diskursit*, në R. Wodak, M. Meyer (eds.), *Metodat e studimeve kritike të diskursit*, botimi i 3-të, Sage, 2016, f., 23–61.

paktën sugjeron një mënyrë për të parë botën përreth²⁸, dhe për këtë arsye, në thelb, zhvillon një “dinamikë argumentuese”²⁹ që mund të nxjerrin në pah dhe të justifikojnë pikëpamjet e mundshme të nënkuptuara për çështjet e debatuar në një kontekst specifik.

Kjo nënkuptimësi e gjuhës së urrejtjes bëhet e dukshme, për shembull, në rastet e objekteve/ artefakteve multimodale (kopertinat e gazetave, postimet në mediat sociale, meme), implikimet dhe supozimet kur pjesa më e madhe e kuptimit që mund të justifikojë urrejtjen mbetet padukshme.³⁰ Si pjesë e diskurseve më të gjera diskriminuese, gjuha e butë e urrejtjes mund të shihet si zhvillim i një argumentimi që, në mënyrë implicite, mund të justifikojë urrejtjen kundër grupeve të synuara, edhe nëse nuk nxit në mënyrë eksplicite urrejtje dhe agresion. Kjo strategji është veçanërisht e shpeshtë në diskursin politik dhe publik, për shembull, pasi u lejon autorëve të kapërcejnë zbulimin e gjuhës së urrejtjes dhe shkeljen e kodeve të sjelljes duke i lënë ata të nxisin reagime të forta negative (nga ndjekësit e tyre, nga opinioni publik) ndaj grupeve (trageteve) të tyre.

Njohja e rrethanave themelore/faktorëve kontekstualë mund të ndihmojë me gjetjen e drejtimit nëpër spektrin e formave të gjuhës së shprehur (dhe kështu, edhe përcaktimin e reagimeve apo formulimin e politikave kundër llojeve të ndryshme të gjuhës së urrejtjes).³¹

MANDATI DHE KOMPETENCAT E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit është institucion i pavarur kushtetues që mbron, mbikëqyr dhe promovon të drejtat dhe liritë e njeriut. Ai vepron si Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ), si Organ i Barazisë (OB) dhe po ashtu si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), që monitoron të gjitha vendet ku mbahen persona të privuar nga liria.

Avokati i Popullit si udhërrëfyes për punën e tij në përmbushjen e misionit të tij ka *Parimet e Parisit*³² dhe *Parimet e Venedikut*³³, të cilat janë kriteret minimale ndërkombëtare që duhet të plotësojë çdo institucion kombëtar për të drejtat e njeriut në një shtet në mënyrë që të mund të konsiderohet kredibil dhe i denjë për kryerjen e mandatit të tij.

Mandati i Avokatit të Popullit është i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinore dhe më vonë edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, por ka kompetenca shtesë edhe në disa ligje të tjera.³⁴

²⁸ Shih Amossy R. *Argumentimi në diskurs. Qasje socio-diskursive ndaj argumenteve*, “Logic Informal”, 29 (3), 2009, f. 252–267 (254).

²⁹ Shih Amossy R., *Dimensioni argumentues i diskursit*, në F.H. van Eemeren, P. Houtlosser, *Praktikat e Argumentimit*, John Benjamins, 2005, f. 87-98.

³⁰ Shih Breazu P., Machin D., *Racizmi ndaj romëve përmes mundësive të Facebook-ut*, cit.

³¹ Përtej kufizimeve, thirrje kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri, shih në :Një studim gjithëpërfshirës, nëntor 2021 <https://rm.coe.int/beyond-definitions-alb/1680a465f8>

³² Parimet e Parisit janë kriteret minimale të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara që duhet të ketë një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare.

³³ Komisioni i Venedikut, Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Ombudsmaneve (Parimet e Venedikut), [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

³⁴ Ligji për Qasjen në Dokumente Publike; Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat; Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligji për Konfliktet Administrative; Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në RKS; Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes; Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale; Kodi i procedurës penale i Kosovës; Ligji për përdorimin e gjuhëve; Ligji për procedurën kontestimore

IAP është i pavarur në ushtrimin e detyrave.³⁵ Ai ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj³⁶ dhe autoritetet publike janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, në pajtim me ligjin.³⁷

Në kuadër të shumë kompetencave të tjera, ai mund të zhvillojë edhe hetime me vetë-iniciativë (Ex Officio) në kuadër të së cilës është iniciuar edhe ky raport. Avokati i Popullit mund të jap rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore³⁸; të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla³⁹; rekomandon Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.⁴⁰

³⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 2.

³⁶ Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 3.

³⁷ Po aty, neni 132, paragrafi 3.

³⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3.

³⁹ Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 19., paragrafi 1, nënparagrafi 1.2

⁴⁰ Po aty, neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5

KORNIZA LIGJORE VENDORE

Kushtetuta e Kosovës

Barazia⁴¹ dhe mosdiskriminimi⁴² janë parimet bazë të Kushtetutës. Liria e shprehjes garantohet me Kushtetutë. Neni 40 parashikon se liria e shprehjes nënkupton të drejtën për t'u shprehur, për të shpërndarë dhe marrë informacion, mendime dhe mesazhe të tjera pa pengesë. Megjithatë, i njëjti nen parashikon se liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj kur është e nevojshme për të parandaluar nxitjen ose provokimin e dhunës dhe armiqësisë në bazë të racës, kombësisë, etnisë ose fesë.

Liria e medias dhe pluralizmi trajtohen shprehimisht në Nenin 42 të Kushtetutës si të drejta të garantuara, ndërsa censura lejohet vetëm në rastet kur është e nevojshme për të parandaluar nxitjen ose provokimin e dhunës dhe armiqësisë në bazë të racës, kombësisë, etnisë ose fesë. E drejta për të korrigjuar informacione të pavërteta, të paplota dhe të pasakta njihet nga i njëjti nen.

Liria e asociimit si formë e lirisë së shprehjes përcaktohet me Nenin 44 të Kushtetutës. Ai ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Ekzistojnë kufizime që mund të zbatohen për organizatat ose aktivitetet që cenojnë rendin kushtetues, cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut ose nxisin urrejtje racore, kombëtare, etnike ose fetare, të cilat mund të ndalohen me vendim të gjykatës kompetente.

Neni 22 i Kushtetutës parashikon zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të një sërë konventash ndërkombëtare me të cilat garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilave u jepet prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.⁴³

Bazuar në nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ).

Standardet dhe instrumentet ndërkombëtare luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e rrugës për mënyrat se si shtetet duhet të reagojnë dhe t'i përmbushin detyrimet e tyre, në raport me të drejtat dhe me liritë e individit. I njëjti parim vlen edhe për lirinë e shprehjes, përfshirë edhe gjuhën e urrejtjes, diskriminuese dhe fyese në diskursin publik, si komponentë që merret parasysh me rastin e kufizimit të lirisë shprehjes ose sanksionimit nëse vlerësohet se cenon sigurinë shtetërore, integritetin territorial dhe sigurinë publike, ruajtjen e rendit dhe parandalimin e parregullsive dhe krimeve, mbrojtjen e

⁴¹ Neni 3 (Barazia para ligjit) dhe Neni 7 (Vlerat i referohen barazisë), të Kushtetutës së Kosovës.

⁴² Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës.

⁴³ *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, shih në https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf; *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe Protokollat e saj* shih në: https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf; *Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat e saj* shih në <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>; *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, shih në <https://rm.coe.int/16800c131a>; *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor* shih në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-convention-elimination-all-forms-racial>; *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Gjnjor*, shih në: <https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAë-a.pdf>; *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës*, shih në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>; *Konventa Kundër Torturës, Trajtimeve e Ndëshkimeve Mizore, Jonjerëzore e Poshtëruese*, shih në: <https://rm.coe.int/16806dbac6>; *Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)* shih në: *Amendament i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nr. 07-v-058, 25 shtator 2020, amendamenti nr. 26*, shih në <https://rm.coe.int/168064d3f6>.

shëndetit dhe moralit, dinjitetit ose të drejtave të tjerëve, si dhe kufizimin e përhapjes së informatave konfidenciale ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë.

Ligji për Avokatin e Popullit

Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe barazisë sigurohet nga Institucioni i Avokatit të Popullit⁴⁴. Roli dhe kompetencat themelore të institucionit janë të përcaktuara me Kushtetutën dhe Ligjin për Avokatin e Popullit⁴⁵. Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁴⁶

Ligji për mbrojtje nga diskriminimi

Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi(LMD) siguron një listë joshterruese të bazave të mbrojtura, si: kombësia apo lidhja me ndonjë komunitet, origjina sociale, raca, etnia, ngjyra, lindja, origjina, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjuha, shtetësia, feja dhe besimi fetar, përkatësia politike, mendimi politik apo mendimi tjetër, gjendja sociale ose personale, mosha, gjendja familjare ose martesore, shtatzënia, lehonja, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, trashëgimia gjenetike ose ndonjë bazë tjetër⁴⁷.

LMD aplikohet për të gjitha veprimet ose mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore, personave fizikë e juridikë, sektorit publik dhe privat, të cilët cenojnë, kanë cenuar ose mund të cenojnë të drejtat e çdo personi apo subjekti fizik e juridik në të gjitha fushat e jetës.⁴⁸ Llojet e trajtimit të pabarabartë specifikohen si diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, diskriminim i bazuar në perceptim, diskriminim i shumëfishtë, ngacmim, nxitje e diskriminimit, viktimizim, segregim, diskriminim i bazuar në shoqërim dhe dështim i një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara. Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë të bazave të përmendura në LMD konsiderohet diskriminim⁴⁹.

Ligji Civil kundër shpifjes dhe fyerjes

Ligji Civil kundër shpifjes dhe fyerjes⁵⁰ vendos përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje duke garantuar parimet e lirisë së shprehjes, duke parashikuar kompensim efektiv për viktimat dhe duke njohur rolin e medias në një proces demokratik. Ligji ka për qëllim promovimin e një shoqërie tolerante dhe demokratike përmes respektimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së shpifjes dhe fyerjes. Ky ligj e vë në rend të parë parimin e lirisë së shprehjes dhe siguron që dispozitat e këtij ligji të interpretohen në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁴⁴ Neni 133, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

⁴⁵ Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit

⁴⁶ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9, dhe Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

⁴⁷ Neni 1, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁴⁸ Neni 2, po aty.

⁴⁹ Neni 4, po aty.

⁵⁰ Ligji Nr. 02/L.65 kundër shpifjes dhe fyerjes

Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, gjuhën e urrejtjes nuk e ka definuar dhe përcaktuar si vepër penale e veçantë. Mirëpo sipas Kodit nëse vepra penale është akt i urrejtjes, do të konsiderohet si rrethanë rënduese dhe ka ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e kufijve të dënimit të paraparë në Kodin Penal. Pra, vetëm gjuha e urrejtjes, pa u shoqëruar me ndonjë akt që përbën vepër penale të dënueshme sipas Kodit penal, nuk përbën vepër penale⁵¹. Ndërsa, nxitja dhe përhapja e urrejtjes, mos durimi midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik sanksionohet me Kodin Penal⁵².

Në një numër të caktuar të veprave penale të përcaktuara me Kodin Penal parashihen forma më të rënda të kualifikuara në rast se motivi për ato vepra ka qenë urrejtja /paragjykimi (shih nenet 173, 184,185,186, 190, 321).

Ligji për zgjedhjet e Përgjithëshme

Ligji përcakton qartë detyrimin e partive politike që të respektojnë Kodin mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, me *“qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit”*⁵³

Gjithashtu ligji ka përcaktuar si veprim të ndaluar *“Përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*. Duhet theksuar se këto ndalime janë përcaktuar vetëm *“Gjatë periudhës së fushatës”*.

Këto detyrime janë reflektuar edhe në Rregullorën Zgjedhore nr 11/2013 Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët

RREGULLIMI I MEDIAS

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është përcaktuar me Kushtetutën e vendit si organ i pavarur që rregullon spektrin e frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.⁵⁴

⁵¹ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, neni 70[Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit, paragrafi 2, nën paragrafi 2.12: [...]

2.12. nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura,, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale; [...].

⁵² Po aty, neni 141

⁵³ Ligji NR. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithëshme <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 141

KPM është organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit.⁵⁵ Ai lëshon dhe ripërtërinë licencat për të gjitha shërbimet e medias audio-vizuale duke dhënë të drejtën e përdorimit të frekuencave në spektrin e frekuencave të transmetimit dhe vendos sanksione për shkeljen e rregullave dhe kushteve të licencës. Kodi i Etikës i KPM-së është i zbatueshëm për të gjithë anëtarët e saj ose për ata që janë të pajisur me licencë. Neni 5 i Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Kosovë në mënyrë specifike ndalon nxitjen e urrejtjes duke përfshirë ndalimin e përdorimit të një numri karakteristikash të mbrojtura, duke përfshirë orientimin seksual për të denigruar, tallur ose përqeshur.⁵⁶ Strategjia e KPM-së për transmetim i nënshtrohet miratimit nga qeveria. KPM-ja kryen monitorim periodik të stacioneve televizive dhe radiofonike për të kontrolluar nëse këto të fundit janë duke i përmbushur obligimet e tyre. Gjithashtu trajton ankesat e qytetarëve në lidhje me sjelljen e organeve mediatike, qofshin ato në televizion apo radio, të cilat janë të rregulluara nga KPM-ja. Në bazë të ligjit për KPM, neni 27 paragrafi 4, ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose indirekt i shprehur nga redaktorët e medias, gazetarët ose persona të tjerë të përfshirë në fushën e transmetimit të informacionit publik.

Bazuar në Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, në nenin 26 thekson se: “Për mosrespektimin e kësaj rregullore aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin e Komisionit të Pavarur të Mediave”. Kjo nënkupton që në bazë të nenit 30 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, për gjuhë të urrejtjes mund të vendoset gjobë pezullim i programit, ndryshim i kushteve të licencës apo ndërprerje e saj.

VETË-RREGULLIMI I MEDIAS

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (**KMShK**) është një organ vetërregullues për mediat e shkruara dhe online në Kosovë. Ai është një organ vetërregullues i bazuar në anëtarësim dhe mund të rregullojë vetëm ata anëtarë që regjistrohen në të. Ai mund të marrë dhe të trajtojë ankesat nga anëtarët e publikut kundër atyre subjekteve që janë anëtarë të KMShK-së. Vendimet e tij për ankesat e marra nga një palë e tretë bazohen në Kodin e tij të Etikës, i cili u përditësua së fundi në dhjetor 2019. Bordi i KMShK-së i cili ka të drejtë të vendosë për ankesat, përbëhet nga përfaqësues të mediave.

Standardet ndërkombëtare duke përfshirë masat në lidhje me gjuhën e urrejtjes

Siç u tha edhe në pjesën hyrëse, nuk ka asnjë përkufizim të pranuar botërisht të gjuhës së urrejtjes në standardet ligjore ndërkombëtare. Megjithatë, kjo çështje është trajtuar në një sërë konventash, kryesisht nëpërmjet garancive për të drejtën e lirisë së shprehjes, përfshirë lirinë e mendimit.

- **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)**⁵⁷

Neni 19 (2) i KNDCP-së është specifik duke pranuar se liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë. Ai vazhdon duke ilustruar se përfshin, “*lirinë për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacione dhe ide të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, gojarisht, me shkrim ose në shtyp, në formën e artit, ose përmes*

⁵⁵ Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 3.

⁵⁶ Gjendet në [1476189555.8908.pdf \(kpm-ks.org\)](https://www.kpm-ks.org/).

⁵⁷ Miratuar me Rezolutën 2200A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 16 dhjetor 1966.

ndonjë mediumi tjetër të zgjedhjes së tij/saj". Referenca për qasjen në informacion, pavarësisht kufijve dhe mediave të zgjedhura të tij/saj, do të thotë se garancia i ka qëndruar provës së kohës, pavarësisht se është hartuar në një kohë kur përparimet teknologjike që shohim sot nuk ishin as në horizont.

Në të njëjtën kohë dhe më e rëndësishmja, Neni 19 (3) pranon shprehimisht se ushtrimi i së drejtës për lirinë e shprehjes "*mbart me vete detyra dhe përgjegjësi të veçanta*". Në veçanti, Neni 19 (3) parashikon se e drejta e lirisë së shprehjes mund t'i nënshtrohet kufizimeve me kusht që këto të parashikohen me ligj dhe janë të nevojshme për të respektuar të drejtat dhe reputacionin e të tjerëve ose mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit apo moralit publik. Për më tepër, Neni 20 ndalon disa lloje të fjalës si propaganda për luftë, e cila duhet të ndalohej me ligj, si dhe çdo mbrojtje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim.

- **Komiteti i të Drejtave të Njeriut (KDNj) – Komenti i Përgjithshëm Nr.34**⁵⁸

KDNj në Komentin e Përgjithshëm Nr. 34 i cili fokusohet në lirinë e mendimit dhe shprehjes e njohur "*liria e mendimit dhe liria e shprehjes janë kushte të domosdoshme për zhvillimin e plotë të personit... thelbësore për çdo shoqëri. Ato përbëjnë gurthemelin për çdo shoqëri të lirë dhe demokratike*".⁵⁹ Ato janë të nevojshme për transparencën, llogaridhënien dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga shtetet palë kërkohet që të zbatojnë të drejtat e përfshira në Nenin 19, si dhe udhëzimet e dhëna nga Komiteti në legjisllacionin vendor.⁶⁰ Në lidhje me kufizimet, Komiteti vëren se çdo kufizim "*nuk mund të vërë në rrezik vetë të drejtën*".⁶¹ Më tej, Komiteti e thekson se paragrafi 3 i Nenit 19 parashtron kushte specifike dhe vetëm në këto kushte mund të vendosen kufizime.⁶²

- **Plani i Veprimit i Rabatit**

Në kuadrin e të drejtave që parashikon Neni 19 i KNDCP-së dhe ndalimeve të parashikuara në Nenin 20 të KNDCP-së, Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut e Organizatës së Kombeve të Bashkuara organizoi si seri seminaresh që rezultuan në Planin e Veprimit të Rabatit.⁶³ Plani i Veprimit të Rabatit fokusohet në ndalimin e mbrojtjes së urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Nëse shprehja duhet të konsiderohet si vepër penale, propozohet një test pragu prej 6 pjesësh, i cili përbëhet nga sa vijon:

1. **Konteksti** – kjo është e rëndësishme të merret parasysh kur vlerësohet nëse deklaratat e veçanta ka të ngjarë të nxisin diskriminim, armiqësi ose dhunë kundër një grupi të synuar;
2. **Folësi** - pozicioni i tyre ose statusi i folësit duhet të merret parasysh dhe audienca e tyre e synuar;
3. **Qëllimi** – Neni 20 i KNDCP-së parashikon qëllimin. Neglizhenca dhe pakujdesia nuk mjaftojnë që një vepër të jetë vepër penale. Kjo kërkon aktivizimin e marrëdhënies trekëndore ndërmjet objektit dhe subjektit të fjalës, si dhe audiencës;
4. **Përmbajtja dhe forma** – analiza e përmbajtjes mund të përfshijë shkallën në të cilën fjalimi ishte provokues dhe i drejtpërdrejtë, si dhe formën, stilin dhe natyrën e argumenteve të përdorura;

⁵⁸ Seanca e 102-të, Gjenevë, 11 – 29 korrik 2011.

⁵⁹ Po aty, paragrafi 2.

⁶⁰ Po aty, paragrafi 8.

⁶¹ Po aty, paragrafi 21.

⁶² Po aty.

⁶³ Publikuar më 5 tetor 2012 dhe në dispozicion në [OHCHR | The Rabat Plan of Action](https://www.ohchr.org/en/docd.aspx?docid=14842).

5. **Shtrirja e aktit të gjuhës** – kjo përfshin marrjen në konsideratë të shtrirjes së gjuhës, natyrës së saj publike, përmasave dhe madhësisë së audiencës së saj, nëse është publike, mjetet e përdorura të shpërndarjes, nëse audienca kishte mjetet për të vepruar mbi nxitjen etj.
6. **Gjasat, duke përfshirë afërsinë** – veprimi i avokuar përmes gjuhës nxitëse nuk duhet të kryhet që gjuha të konsiderohet krim. Megjithatë, duhet të identifikohet një shkallë e rrezikut të dëmtimit. Gjykatat do të duhet të përcaktojnë se ekzistonte një probabilitet i arsyeshëm që gjuha të kishte sukses në nxitjen e veprimit aktual kundër grupit të synuar duke pranuar se një shkak i tillë duhet të jetë i drejtpërdrejtë.

• **Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KNEDR)**⁶⁴

Neni 4 i KNEDR-së kërkon që të gjitha shtetet palë të dënojnë të gjitha propagandat dhe organizatat që besojnë në epërsinë e një race ose grupi personash me ngjyrë ose origjinë etnike, ose që përpiqen të justifikojnë ose promovojnë urrejtje racore ose diskriminim në çfarëdo forme. Përveç kësaj, ai kërkon që shtetet të miratojnë masa të menjëhershme dhe pozitive “*të projektuara për të çrrënjësuar çdo nxitje, ose akte ose, diskriminim të tillë*”. Në veçanti, ai kërkon që shtetet të:

- Shpallin një vepër të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsi ose urrejtje racore, nxitje për diskriminim racor, si dhe të gjitha aktet e dhunës ose nxitjet për akte të tilla kundër çdo race ose grupi personash me ngjyrë ose origjinë etnike tjetër, dhe gjithashtu ofrimin e asistencës për aktivitetet raciste duke përfshirë financimin e aktiviteteve të tilla;
- Shpallin të paligjshme dhe të ndalojnë organizatat, si dhe të gjitha aktivitetet e organizuara dhe të tjera propagandistike, të cilat promovojnë dhe nxisin diskriminimin racor, me pjesëmarrjen në këto organizata ose aktivitete, të njihen si shkelje;
- Të mos lejojnë autoritetet publike ose institucionet publike, kombëtare apo lokale, të promovojnë ose nxisin diskriminimin racor.

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KEDR) – Komenti i Përgjithshëm Nr.35⁶⁵

KEDR-ja në Komentin e Përgjithshëm nr. 35 mbi luftën kundër gjuhës së urrejtjes raciste pranon se “*Gjuha e urrejtjes raciste mund të marrë shumë forma dhe nuk kufizohet në komente të qarta racore... gjuha që sulmon një grup të caktuar racor ose etnik mund të përdorë gjuhë indirekte për të maskuar synimet ose objektivat e saj*”.⁶⁶ Si rezultat, dhe në përputhje me detyrimet e tyre, shteteve u kërkohet t’i kushtojnë vëmendjen e duhur të gjitha manifestimeve të gjuhës së urrejtjes raciste dhe të marrin masa efektive për t’i luftuar ato.

KNEDR-ja rekomandon që kriminalizimi i shprehjes raciste duhet të rezervohet për rastet e rënda, të cilat janë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ndërsa rastet më pak të rënda duhet të trajtohen me mjete të tjera përveç ligjit penal, duke marrë parasysh natyrën dhe shtrirjen e ndikimit në grupet ose personat e synuar. Kur zbatohen sanksionet penale, ato duhet të udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë.⁶⁷

⁶⁴ Miratuar me Rezolutën 2106 (xx) të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 21 dhjetor 1965.

⁶⁵ Miratuar më 26 shtator 2013.

⁶⁶ Po aty, paragrafi 7.

⁶⁷ Po aty, paragrafi 12.

Megjithatë, ai pranon gjithashtu se disa çështje në përputhje me detyrimet e përcaktuara në KNEDR duhet të sanksionohen si vepra të dënueshme me ligj⁶⁸, të cilat janë:

- Të gjitha përhapjet e ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen racore ose etnike, me çfarëdo mjeti;
- Nxitja e urrejtjes, përbuzjes ose diskriminimit ndaj anëtarëve të një grupi për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes së denjë ose kombëtare ose etnike;
- Kërcënime ose nxitje për dhunë ndaj personave ose grupeve për arsytet e përmendura më sipër;
- Fyerjet, talljet ose shpifjet e personave ose grupeve ose justifikimi i urrejtjes, përbuzjes ose diskriminimit në bazat e përmendura më sipër, kur qartazi përbën urrejtje ose diskriminim;
- Pjesëmarrja në organizata dhe aktivitete që promovojnë dhe nxisin diskriminimin racor.

Më tej, KNEDR-ja rekomandon që mohimet publike ose përpjekjet për të justifikuar krimet e gjenocidit dhe krimet kundër njerëzimit, siç përcaktohen nga ligji ndërkombëtar, duhet të shpallen si vepra të dënueshme me ligj, me kusht që ato qartësisht përbëjnë nxitje për dhunë racore ose urrejtje. Megjithatë, shprehja e opinioneve për faktet historike nuk duhet të ndalohej apo ndëshkohet.⁶⁹

• Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)

Ngjashëm me KNDKP-në, në nivel evropian, Neni 10 (1) i KEDNj-së parashikon se secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informata dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike.

Megjithatë, Neni 10 (2) pranon gjithashtu se këto liri u nënshtrohen detyrave dhe përgjegjësi të caktuara. Për më tepër, ato mund t'u nënshtrohen formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose ndëshkimeve të mëposhtme, me kusht që këto të parashikohen me ligj dhe të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Është gjithashtu i rëndësishëm Neni 17 i KEDNj-së, i cili parashikon se asgjë në Konventë nuk mund të interpretohet se nënkupton për ndonjë shtet, grup ose person ndonjë të drejtë për t'u përfshirë në ndonjë aktivitet për të kryer ndonjë veprim që synon shkatërrimin e ndonjë të drejte dhe lirie të parashikuar ose kufizimi i tyre në një masë më të madhe se sa parashikohet. GjEDNj-ja ka paraqitur një numër rastesh të papranueshme, ku një aplikant me përdorimin e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së urrejtjes ka kërkuar të argumentojë lirinë e shprehjes. Në rastin e *Glimmerveen dhe Hagenbeek k. Holandës*⁷⁰, aplikantët ishin dënuar për posedimin e fletëpalosjeve drejtuar "holandezëve të bardhë", të cilat jepnin një mesazh që të gjithë ata që nuk ishin të bardhë të largoheshin nga Holanda. Çështja u shpall e papranueshme nga Gjykata duke konstatuar se Neni 17 (ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave) i KEDNj-së nuk lejonte përdorimin e Nenit 10 (liria e shprehjes) për përhapjen e ideve që janë diskriminuese në aspektin racor.

⁶⁸ Po aty, paragrafi 13.

⁶⁹ KNEDR, Komenti i Përgjithshëm Nr.35, paragrafi 14.

⁷⁰ Vendimi i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (përpara se Gjykata të krijohej në baza të përhershme), 11 tetor 1979.

REKOMANDIMET NGA KËSHILLI I EVROPËS

- **Rekomandimi (97) 20 për gjuhën e urrejtjes⁷¹**

Komiteti i Ministrave përmes këtij rekomandimi në vitin 1997 e përkufizoi gjuhën e urrejtjes si *“të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë apo arsyejnë urrejtjen raciste, ksenofobinë, antisemitizmin apo format e tjera të urrejtjes të bazuara në intolerancë duke përfshirë: intolerancën e shprehur përmes nacionalizmit agresiv dhe etnocentrizmit, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj minoriteteve, imigrantëve dhe njerëzve me prejardhje imigrantësh”*.⁷² Fokusi i rekomandimit ishte në gjuhën e urrejtjes duke përfshirë shpërndarjen përmes mediave dhe bëri një sërë rekomandimesh..⁷³

- **Rekomandimi CM/Rec (2022) 16 për luftimin e gjuhës së urrejtjes⁷⁴**

Ky Rekomandim i fundit i Komitetit të Ministrave përditëson përkufizimin e gjuhës së urrejtjes duke e përkufizuar atë si *të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal real ose të atribuuar si raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual*.⁷⁵ Për më tepër, Rekomandimi pranon se gjuha e urrejtjes mbulon një sërë shprehjesh të urrejtjes të cilat ndryshojnë në ashpërsinë e tyre, dëmin e shkaktuar, ndikimin në grupe të veçanta dhe në këtë drejtim, shteteve anëtare u kërkohet të sigurojnë një sërë masash për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes. Masa të tilla duhet të përputhen me KEDNj-në dhe jurisprudencën e GjEDNj-së dhe duhet të bëjnë dallimin midis:

- Gjuhës së urrejtjes që e ndalon sipas ligjit penal;
- Gjuhës së urrejtjes që nuk arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për përgjegjësi penale, por i nënshtrohet ligjit civil ose administrativ;
- Llojet fyese ose të dëmshme të shprehjes, të cilat nuk janë mjaftueshëm të rënda për t'u kufizuar në mënyrë legjitime sipas KEDNj-së, por kërkojnë përgjigje alternative si: kundër-gjuha, nxitja e dialogut dhe mirëkuptimit ndërkulturor, duke përfshirë median dhe mediat sociale, dhe aktivitetet përkatëse edukative, të shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit.⁷⁶

Gjatë vlerësimit të ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimit të llojit të përgjegjësisë që duhet të zbatohet, duhet të ndiqet jurisprudenca e GjEDNj-së. Për më tepër, rekomandohet që të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Përmbajtja e shprehjes;
- Konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes;
- Qëllimi i folësit;
- Roli dhe statusi i folësit në shoqëri;

⁷¹ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të zëvendësministrave.

⁷² Shtojca e Rekomandimit Nr. R(97) 20, Fushëveprimi.

⁷³ Po aty, Parimi 6.

⁷⁴ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 maj 2022 në seancën e 132-të të Komitetit të Ministrave

⁷⁵ Shtojca e Rekomandimit CM/Rec (2022) 16, para 2.

⁷⁶ Po aty, para. 2.

- Si shpërndalet apo përfordhet shprehja;
- Aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla;
- Natyra dhe madhësia e audiencës;
- Karakteristikat e grupit të synuar.⁷⁷

Rekomandimi CM/Rec (2022) 16, gjithashtu ofron një numër rekomandimesh, të cilat shtetet anëtare duhet t'i zbatojnë dhe adreson rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit për të trajtuar shkaqet rrënjësore të gjuhës së urrejtjes,⁷⁸ si dhe ofrimin e mbështetjes për ata që janë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes përmes ndihmës psikologjike, mjekësore dhe ligjore.⁷⁹ Në të njëjtën kohë, ai pranon se monitorimi dhe analizimi i gjuhës së urrejtjes është gjithashtu i rëndësishëm,⁸⁰ siç është koordinimi kombëtar dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.⁸¹

PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (GJEDNJ)

GJEDNJ e interpreton nenin 10 të KEDNJ si një mbrojtje të fortë për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe e përshkruan si *"një nga themelet kryesore të shoqërisë demokratike dhe një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe për përmbushjen vetjake të çdo individi"*.⁸²

Gjykata në vendimin e saj themelor në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, e thekson se liria e shprehjes *"gjen zbatim jo vetëm për "informacionin" ose "idetë" që pranohen pozitivisht apo konsiderohen si të padëmshme ose çështje për t'u shpërfillur, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo grup të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur, pa të cilat nuk ka një "shoqëri demokratike"*.⁸³ Ky parim krijon hapësirën e nevojshme për një debat publik të fortë e pluralist në shoqërinë demokratike.⁸⁴

Sa i përket ndërlidhjes midis debatit të fortë dhe interesave të reputacionit, GjEDNJ e ka theksuar se *"në këtë fushë, fyerjet politike shpesh shtrihen edhe në sferën personale; të tilla janë rreziqet e politikës dhe debatit të lirë të ideve, që përbëjnë garancitë e një shoqërie demokratike"*.⁸⁵

Në Vendimin *Handyside*, gjykata ka interpretuar që sipas doktrinës së kufirit të vlerësimit, që merr parasysh si interpretohet Konventa në nivel kombëtar, shteteve iu jepet një shkallë e caktuar lirie veprimi në mënyrën sesi rregullojnë shprehjen. Edhe pse shtetet gëzojnë vetëm një kufi të ngushtë vlerësimi në raport me shprehjen në fushën politike, ata kanë kufi më të gjerë sa i përket moralit, mirësjelljes dhe fesë.

⁷⁷ Po aty, para. 4.

⁷⁸ Po aty, seksioni 4.

⁷⁹ Po aty, seksioni 5.

⁸⁰ Shtojca e Rekomandimit CM/Rec (2022) 16, seksioni 6.

⁸¹ Po aty, seksioni 7.

⁸² Çështja *Lingens kundër Austrisë*, paragrafi 41, në ndërlidhje me çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 49.

⁸³ Çështja *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 49

⁸⁴ Liria e shprehjes dhe fyerja, Një studim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Tarlach McGonagle, mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, qershor 2018.

⁸⁵ Çështja *Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë*, paragrafi 34; si dhe çështja *Kuliš kundër Polonisë*, paragrafi 52.

Kjo kundërshti shpjegohet zakonisht me pranimin prej një kohe të gjatë të rëndësisë që ka në demokraci shprehja politike në kuptim të gjerë dhe me mungesën e një konsensusi evropian lidhur me faktin nëse/si duhen rregulluar çështje të tilla si morali publik, sjellja e njerëzishme dhe feja.⁸⁶

- **Vejdeland dhe të tjerët k. Suedisë**⁸⁷

Aplikantët në këtë rast kishin shpërndarë 100 fletëpalosje në një shkollë të mesme për një grup të quajtur Rinia Kombëtare. Deklaratat në fletëpalosje pretendonin se homoseksualiteti ishte një *"prirje devijuese seksuale"*, kishte *"një efekt moralisht shkatërrues në thelbin e shoqërisë"* dhe ishte përgjegjës për zhvillimin e HIV dhe AIDS. Më tej, organizatat që lobuan për të drejtat e homoseksualëve përqipen të *"minimizojnë pedofilinë"*. Aplikantët u dënuan nga gjykatat suedeze për agjitacion kundër një grupi kombëtar ose etnik. Në sjelljen e rastit përpara GjEDNj-së, aplikantët argumentuan se gjykatat suedeze kishin shkelur të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes, se nuk kishin synuar të shprehnin përbuzje për homoseksualët dhe se qëllimi i aktivitetit kishte qenë nisja e një debati për mungesën e objektivitetit në sistemin arsimor në shkollat suedeze. GjEDNj-ja konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 10 (liria e shprehjes), pasi ndërhyrja në ushtrimin e së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes nga aplikantët ishte konsideruar në mënyrë të arsyeshme nga autoritetet suedeze si *"e nevojshme në një shoqëri demokratike"* për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve. Për më tepër, GjEDNj-ja konstatoi se deklaratat e bëra përbënin pretendime serioze dhe paragjyqese, edhe nëse ato nuk do të kishin qenë një thirrje e drejtpërdrejtë për akte urrejtjeje. Më tej, GjEDNj-ja theksoi se *"diskriminimi në bazë të orientimit seksual ishte i rëndësishëm sikurse diskriminimi në racë, origjinë ose ngjyrë"*.⁸⁸

- **Jerslid k. Danimarkës**⁸⁹

Aplikanti, një gazetar kishte bërë një dokumentar me disa të rinj që i referoheshin vetes si *"xhaketa jeshile"*, të cilët bënin abuzime dhe komente nënçmuese për emigrantët dhe grupet etnike në Danimarkë. Ai ishte dënuar për ndihmë dhe nxitje në shpërndarjen e komenteve raciste. Aplikanti pretendoi shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes. GjEDNj-ja bëri një dallim midis anëtarëve të *"xhaketa të gjelbra"*, të cilët bënin haptas komente raciste, dhe aplikantit, një gazetar që kërkonte t'i ekspozonte ata në mënyrë që publiku të mund të informohej. Më tej, qëllimi i dokumentarit nuk kishte për qëllim propagandimin e pikëpamjeve raciste, por ishte informimi i publikut për një çështje të rëndësishme dhe si e tillë ishte shkelur e drejta e aplikantit për lirinë e shprehjes. GjEDNj-ja vuri në dukje se *"Raportimi i lajmeve i bazuar në intervista të redaktuara ose jo, është një nga mjetet më të rëndësishme me anë të të cilit shtypi është në gjendje të luajë rolin e tij si mbikëqyrës publik. Ndërkimi i një gazetari për ndihmën në përhapjen e deklaratave të bëra nga një person tjetër në një intervistë mund të dëmtojë seriozisht kontributin e shtypit në diskutimin e çështjeve me interes publik dhe nuk duhet të parashikohet përveçse nëse ka arsye veçanërisht të forta për ta bërë këtë"*.⁹⁰

⁸⁶ Liria e shprehjes dhe fyerja, Një studim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Tarlach McGonagle, mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, qershor 2018, shih në: <https://rm.coe.int/liria-e-shprehjes-dhe-fyerja-alb-sep-2018-final/16808e529e>

⁸⁷ (Kërkesa Nr. 1813/07), 9 maj 2012.

⁸⁸ Po aty, paragrafi 55.

⁸⁹ (Kërkesa Nr. 15890/89), 23 shtator 1994.

⁹⁰ Po aty, paragrafi 35.

- Féret k. Belgjikës⁹¹

Aplikanti ishte anëtar i Parlamentit belg dhe kryetar i partisë politike Fronti Kombëtar. Gjatë një fushate zgjedhore, një numër fletëpalosjesh u shpërndanë me slogane duke përfshirë *"ngrihuni kundër islamizimit të Belgjikës"*, *"ndaloni politikën e rreme integruese"* dhe *"dërgoni punëkërkesit e huaj në shtëpi"*. Ai u dënua për nxitje të diskriminimit racor për të cilin kreu një dënim në komunitet dhe u skualifikua nga mbajtja e postit parlamentar për 10 vjet. Aplikanti pretendoi se dënimi i tij shkeli të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. GjEDNj-ja konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes. Komentet e tij kishin mundur të ngjallnin ndjenja mosbesimi, refuzimi ose urrejtjeje ndaj të huajve. Konteksti i komenteve të tilla të bëra gjatë një procesi zgjedhor ishte një konsideratë e rëndësishme dhe qartësisht kishte çuar në nxitje të urrejtjes racore. Në këto rrethana, dënimi i aplikantit ishte justifikuar në interes të parandalimit të çrregullimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve.

- Delfi AS k. Estonisë⁹²

Aplikanti drejton një portal të ri mbi baza tregtare. Ai u mbajt përgjegjës nga gjykatat kombëtare estoneze për komentet fyese të postuara nga lexuesit e tij në një artikull lajmesh në internet për një kompani tragetesh. Pas një kërkesë nga kompania e trageteve, aplikanti hoqi komentet fyese rreth 6 javë pas publikimit. Aplikanti pretendoi se përgjegjësia për komentet e palës së tretë ishte një shkelje e së drejtës së tij për lirinë e shprehjes. Më tej, Gjykata vlerësoi se natyra ekstreme e komenteve në fjalë, fakti që ato ishin publikuar në përgjigje të një artikulli të publikuar nga aplikanti në një platformë që menaxhohej dhe shfrytëzohej në mënyrë profesionale për qëllime tregtare, masat e marra nga aplikanti ishin të pamjaftueshme për t'i hequr ato pa vonesë. Ndërsa gjopa e vendosur ishte e moderuar dhe kështu gjetja e përgjegjësive ndaj aplikantit në rrethanat kishte qenë një kufizim i justifikuar dhe proporcional i lirisë së shprehjes së aplikantit.

- Smajic k. Bosnjë dhe Hercegovinës⁹³

Aplikanti ishte dënuar për nxitje të urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, mosmarrëveshje ose intolerancë pas një numri postimesh në një forum në internet që përshkruanin veprimet ushtarake që mund të ndërmerreshin kundër fshatrave serbe në rrethin e Brçkos në rast të një lufte tjetër. Aplikanti pretendoi se dënimi i tij ishte një shkelje e së drejtës së tij për lirinë e shprehjes duke qenë se ai kishte shprehur mendimin e tij për një çështje me interes publik. GjEDNj-ja shpalli rastin të papranueshëm si qartazi të pabazuar. Megjithatë, ajo vuri në dukje se gjykatat vendase e kishin shqyrtuar rastin e aplikantit me kujdes dhe dhanë arsytim të mjaftueshëm për dënimin e tij. Në veçanti, ata vunë re se gjuha që ai kishte përdorur ishte fyese ndaj serbëve dhe kjo prekte çështjen shumë të ndjeshme të marrëdhënieve etnike në shoqërinë boshnjake pas konfliktit. Më tej, dënimet e shqiptuara, përkatësisht dënimi me kusht dhe sekuestrimi i kompjuterit nuk kishin qenë të tepruara. Në përgjithësi, ndërhyrja në të drejtën e aplikantit për lirinë e shprehjes ishte parashikuar me ligj dhe kishte ndjekur një qëllim legjitim për të mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve.

⁹¹ (Kërkesa Nr. 15615/07), 16 korrik 2009.

⁹² (Kërkesa Nr. 64569/09), 16 qershor 2015.

⁹³ (Kërkesa Nr. 48657/16), 8 shkurt 2018.

STANDARDE TË TJERA EVROPIANE

Në kuadër të Këshillit të Evropës, ka standarde të tjera që duhen përmendur, të cilat ofrojnë njohuri të dobishme. Ato janë:

Konventa për krimin kibernetik⁹⁴

Kjo trajton një sërë veprash që mund të kryhen nëpërmjet përdorimit të sistemeve kompjuterike dhe kërkon që palët kontaktuese të përdorin këtë kuadër në prezantimin e legjislacionit kombëtar, si dhe të bashkëpunojnë në ndjekjen penale të këtyre veprave. Ajo nuk trajton në mënyrë specifike gjuhën e urrejtjes. Megjithatë, ky boshllëk është korrigjuar pjesërisht përmes Protokollit Shtesë të Konventës për krimin kibernetik, në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike⁹⁵(Protokoll). Ai përcakton "*materiale raciste dhe ksenofobike* si çdo material, imazh ose paraqitje tjetër e ideve ose teorive, që mbron, promovon ose nxit urrejtje, diskriminim ose dhunë, ndaj çdo individi ose grupi individësh, bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje ose origjinë kombëtare ose etnike, si dhe në religjion nëse përdoret si pretekst për ndonjë nga këta faktorë. Protokoll kërkon që shtetet palë të miratojnë masa legjislative dhe masa të tjera për të vendosur vepra penale sipas ligjeve vendore ku sistemet kompjuterike përdoren për:

shpërndarjen e materialeve raciste dhe ksenofobike;
bërjen e kërcënimeve ose fyerjeve të motivuara raciste dhe ksenofobike;
mohimin, minimizimin, miratatimin ose justifikimin e akteve që përbëjnë gjenocid ose krime kundër njerëzimit;
të ndihmuar ose nxitur ndonjë nga çështjet e përmendura më sipër.

Rekomandimi nr. 15 i politikës së përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) - Luftimi i gjuhës së urrejtjes⁹⁶

KERI bën një sërë rekomandimesh të rëndësishme se si shtetet mund të synojnë gjuhën e urrejtjes dhe ato përfshijnë:

- Kërkimin për të identifikuar kushtet e favorshme për përdorimin e gjuhës së urrejtjes, si dhe për të matur shkallën e saj dhe dëmin që shkakton, me qëllim që ta dekurajojë, ta parandalojë dhe të zvogëlojë/të korrigjojë dëmin e shkaktuar;
- Përdorimin e qasjeve energjike për të rritur ndërgjegjësimin për pluralizmin, rreziqet që vijnë nga gjuha e urrejtjes dhe për të demonstruar pavërtetësinë e themeleve mbi të cilat bazohet dhe papranueshmërinë e saj;
- Ofrimin e mbështetje për ata që janë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes si individualisht ashtu edhe kolektivisht;
- Ofrimin e mbështetjes për vetërregullimin nga institucionet publike dhe private (duke përfshirë organet e zgjedhura, partitë politike, institucionet arsimore dhe organizatat kulturore dhe sportive) si një mjet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes;

⁹⁴ Miratuar në Budapest më 23 nëntor 2001

⁹⁵ Ka hyrë në fuqi më 1 mars 2006.

⁹⁶ Miratuar më 8 dhjetor 2015.

- Përdorimin e fuqive rregullative në lidhje me median (përfshirë ofruesit e internetit, ndërmjetësit në internet dhe mediat sociale) për të promovuar veprime për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe për të sfiduar pranueshmërinë e saj, por duke siguruar që një veprim i tillë të mos cenojë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mendimit;
- Qartësimin e fushëveprimit dhe zbatueshmërisë së përgjegjësive sipas së drejtës civile dhe administrative për përdorimin e gjuhës së urrejtjes që nxit ose synon të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi ndaj atyre që janë në shënjestër, gjersa duke respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mendimit;
- Tërheqjen e të gjitha formave të mbështetjes financiare dhe të tjera nga organet publike nga partitë politike dhe organizatat e tjera që përdorin gjuhën e urrejtjes ose nuk e sanksionojnë përdorimin e saj nga anëtarët e tyre dhe siguron, duke respektuar të drejtën e lirisë së asociimit, mundësinë e ndalimit ose shpërbërjes së organizatës pavarësisht nëse marrin ndonjë formë të mbështetjes nga organet publike kur përdorin gjuhën e urrejtjes;
- Ndërmarrjen e veprimeve të përshtatshme dhe efektive kundër përdorimit, në një kontekst publik, të gjuhës së urrejtjes nëpërmjet përdorimit të ligjit penal, me kusht që asnjë masë tjetër, më pak kufizuese, të mos jetë efektive dhe të respektohet e drejta për lirinë e shprehjes dhe mendimit;

PRAKTIKA GJYQËSORE VENDORE NË RASTET E GJUHËS SË URREJTJES

Vendi ynë ende nuk ka një sistem të konsoliduar për mbledhjen e të dhënave për krimin e kryer nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes, si dhe për raportimin për to. Rastet që kanë përfunduar në gjykatë dhe është vendosur për to, mund të gjenden në web faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, megjithatë publikimi i tyre nuk është në bazë të veprës së kryer dhe të dënueshme, çka e vështirëson identifikimin e rasteve që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes. Nga rastet që mediat kanë njoftuar publikun e gjerë dhe nga ajo që mund të gjendet në faqen zyrtare të KGJK në internet po i paraqesim disa në vijim.

- **Rasti - PS.Nr.20/19 - Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti Special, 5 dhjetor 2019⁹⁷**

I.T.në atë kohë ministër në Qeverinë e Kosovës, kishte marr pjesë në një tubim që ishte organizuar me qytetarë, i cili nuk ishte organizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës apo nga Ministria që e drejtonte. Ky tubim ishte organizuar nga disa qytetarë të cilët kundërshtonin ndërhyrjen e NATOS. Me këtë rast i pandehuri i ishte drejtuar masës së qytetareve të komunitetit serb, me fjalët, *“Arsyeja për agresionin në shtetin tone ka qene e ashtuquajtura katastrofë humanitare, Reçaku u shpik në Kosove e Metohi dhe ishin ata terroristet shqiptar që shpiken të gjitha këto, kryen krimet me të mëdha në Kosove dhe Metohi për të cilat askush deri me sot nuk ka marr përgjegjësi. Kane kryer krime para agresionit të NATO-s, kane vrarë shtëpiak të mire serb dhe polic në vendin e tyre të punës, vazhduan festen e përgjakshme gjate agresionit dhe pas ardhjes të se ashtuquajturës mision paqësor në Kosovës e Metohi”*.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special kishte marrë aktgjykimin PS.nr.59/2021 të datës.19.10.2022, me të cilin kishte shpallur fajtor të akuzuarin (ish ministër në Qeverinë e Kosovës). për veprën penale Nxitja e urrejtjes, përparjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni

⁹⁷ Ajo që vijon është një përmbledhje e Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata, e cila aktualisht nuk është e disponueshme në internet. Ndryshe, rasti është pasqyruar nga një sërë mediash. Shembull i këtij rasti mund të gjendet këtu: <https://shorturl.at/hmwCV>

147 paragrafi 1 i KPRK-ës, për të cilën vepër penale e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pas ankesës çështja kishte kaluar në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit- Departamenti Special, kishte nxjerr Aktgjykim APS. nr.2/2023 me të cilin kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore..⁹⁸

- **Rasti P. Nr. 160/20 – Gjykata Themelore e Prizrenit - 24 gusht 2021⁹⁹**

Me këtë rast, një person kishte bërë një sërë postimesh në rrjetin social Facebook në lidhje me besimin islam në Kosovë dhe ndikimin e tij në traditat e shqiptarëve të Kosovës. Për shembull, ai raportohet të ketë thënë *“që nga pavarësia e Kosovës, ne po dëshmojmë se Kosova është shtet arab brenda Evropës”*. Më tej se *“Kleri Islam në trojet shqiptare, me tërë arsenalin e tij lufton kundër simboleve tradicionale shqiptare, dhe personaliteteve emblematike kombëtare, Skënderbeut, dhe nënë Terezës, kundër traditave shqiptare si dhe për zhbërjen e kombit Shqiptar duke e ‘shkinuar’*. Kjo nxiti një numër përdoruesish që të komentojnë postimet e tij. Gjykata e shpalli fajtor dhe e dënoi me gjobë.

- **Rasti P. Nr. 613/21 – Gjykata Themelore e Gjakovës - 24 mars 2022¹⁰⁰**

Në këtë rast, dy persona janë shpallur fajtorë për nxitje të urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës ndërmjet grupeve etnike (shqiptare dhe serbe) në bazë të Nenit 141 (1) të Kodit Penal. Këta persona kishin shpërndarë disa fotografi që tregonin personat e vrarë gjatë luftës në Kosovë në një ndërtesë banimi ku kishte banor (etnikisht serb). Fotot kishin në shënjestër këtë individ me etni serbe, rasti përfundoi në gjykatë të dy këta persona u dënuan me gjobë për veprën e kryer.

- **Rasti P. Nr. 28/2021 – Gjykata Themelore e Mitrovicës - 25 mars 2022¹⁰¹**

Një personi kishte spërkatur në murin e një shkollë ku frekuentonin nxënës etnikisht serbë dhe kishte shkruar fjalën “UÇK”. I pandehuri u akuzua dhe u dënua për nxitje të urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës ndërmjet grupeve etnike. Gjykata e pranoi ankesën pasi nuk ishte e bindur se në rrethanat e kësaj çështjeje ishin provuar elementët e krimit sipas Nenit 141 pika 1 e Kodit Penal. Gjykata tha se grafiti duhej të shqyrtohej në dritën e rrethanave të kohës kur u pikturua dhe, në këtë rast, nuk përbënte nxitje urrejtjeje pasi nuk bënte thirrje për hakmarrje ose dhunë ose tallje ose përqeshje. “Gjuha” përmes grafitëve i referohej një ngjarjeje nga e kaluara dhe jo një thirrje për veprim 20 vjet më vonë.

- **Rasti– Lënda numër 2021: 137347 Gjykata Themelore e Prishtinës - 9 gusht 2021¹⁰²**

Një shtetas i Malit të Zi gjatë manifestimit vjetor “Vidov Dan”, në Mazgit, Komuna e Obiliqit, në afërsi të monumentit të “Gazimestanit”, publikisht dhe në prani të një numri qytetarësh kishte bërë thirrje “vriteni shqiptarin”, “Do ta lajmë Kosovën në gjak”, “Kosova është Serbi”. Gjykata kishte nxjerr Aktgjykim me të cilin e shpall këtë person fajtor për nxitje të urrejtjes dhe i shqiptoi dënimin me 6 muaj burgim, por duke marrë parasysh kohën e vuajtur në paraburgim dhe për pjesën e mbetur gjobë prej 6700 euro, si dhe kishte shqiptuar një urdhër dëbimi me ndalim hyrje për 5 vjet.

⁹⁸ Aktgjykimi është nxjerr në kohës sa Avokati I Popullit ishte në përpilim të këtij raporti.

⁹⁹ Gjendet në [0191-Aktgjykimi \(gjyqesori-rks.org\)](http://0191-Aktgjykimi(gjyqesori-rks.org)).

¹⁰⁰ Gjendet në [0191-Aktgjykimi \(gjyqesori-rks.org\)](http://0191-Aktgjykimi(gjyqesori-rks.org)).

¹⁰¹ Gjendet në [0191-Aktgjykimi \(gjyqesori-rks.org\)](http://0191-Aktgjykimi(gjyqesori-rks.org)).

¹⁰² Gjendet në [0191-Aktgjykimi \(gjyqesori-rks.org\)](http://0191-Aktgjykimi(gjyqesori-rks.org)).

- **Rasti – P. Nr. 319/20 – Gjykata Themelore e Pejës - 2 mars 2021**¹⁰³

Një person u dënua për nxitje të urrejtjes ndërmjet grupeve etnike në bazë të Nenit 141 (1) të Kodit Penal për shkak të komenteve të postuara në një faqe në rrjetet sociale. Në një rast, i pandehuri kishte komentuar një artikull në një platformë të mediave sociale me titullin *“Alarmuese 15,000 qytetarë istogas kanë aplikuar për vizë”*. I pandehuri ishte një komentues i dalluar (top fan) i kësaj faqeje. Komenti i tij thoshte *“ata nuk kanë qare pa ikë nga ky vend, ku hala na malltretojnë boshnjakët dhe “shkitë” në policinë e Istogut...”*. Një tjetër komenton se ai vë në shënjestër një zyrtar policor në stacionin lokal. I pandehuri është dënua me gjobë.

RASTET E TRAJTUARA NGA INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 468/2019 - lidhur me detyrimet pozitive të shtetit.¹⁰⁴

Sa i përket ndikimit të mediave sociale në jetën e përditshme dhe rrezikut që mund t'i kanoset viktimave potenciale, përfshirë edhe mosveprimin apo veprimin e vonshëm të autoriteteve përgjegjëse e thekson edhe Raporti i Avokatit të Popullit (ex officio 468/2019). Hetimet *ex-officio* për rastin në fjalë, Avokati i Popullit i inicioi pas një artikulli të titulluar *“Policia flet për gruan ‘misterioze’ që u pa nëpër Kosovë*, të publikuar në një portal online. Në rrjetet sociale dhe portale të tjera online u raportua se një grua kishte rrëmbyer disa fëmijë në komuna të ndryshme. Në rrjetin social Facebook ka pasur edhe një postim me një grua në një stacion autobusi me mbishkrimin *‘ruaju nga kjo grua, ajo po rrëmben fëmijë’*. Informacioni u përhap shpejt nëpër mediat sociale dhe portalet online, duke përhapur kështu një informacion të pavërtetë se personi i identifikuar mund të jetë një mashkull i veshur si femër dhe dyshimi se personi mund të jetë transgjinnor, duke nxitur kështu edhe urrejtjen ndaj personit. Raportimet e mëtejshme mediatike vazhduan duke përfshirë deklaratën publike të policisë se gruaja në fjalë, nuk kishte kryer ndonjë vepër penale, por fotografia e saj u shpërnda në rrjetet sociale nga disa të rinj për të qeshur me të. Më pas ajo u sulmua nga disa të rinj në Lipjan dhe disa ditë më vonë edhe në Ferizaj. Informacioni që shpërndahej përmes mediave sociale dhe televizionit e përshkallëzuan shpejt situatën duke rezultuar në një sulm fizik si dhe poshtërim publik të viktimës. Pas përfundimit të hetimit përkitazi me këtë rast, Avokati i Popullit ka konstatuar se autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore apo standardet ndërkombëtare në mbrojtjen e gruas nga sulmet që pësoi. Rrjedhimisht ka konstatuar shkelje të një sërë të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe i është drejtuar me rekomandime autoriteteve përkatëse.

GJUHA NË DISKURSION PUBLIK, SIPAS KPM-SË

Komisioni i Pavarur i Mediave (tutje: KPM) është institucion i pavarur kushtetues, mandati dhe funksionimi i së cilës është përcaktuar me kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me Ligjin për KPM-në. Sipas Kushtetutës, KPM-ja është institucioni i vetëm i cili rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit, si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.¹⁰⁵

¹⁰³ Gjendet në [0191-Aktgjykimi \(gjyqesori-rks.org\)](https://www.gjyqesori-rks.org/).

¹⁰⁴ Rasti *ex officio* nga Institucioni i Avokatit të Popullit, 9 dhjetor 2019 gjendet në <https://shorturl.at/enIN0>

¹⁰⁵ Neni 141 Komisioni i Pavarur i Mediave

Avokatit të Popullit i janë ofruar të dhëna nga zyrtarët përgjegjës në KPM¹⁰⁶ përkitazi me vperimet që KPM ka ndërmarrë në raport gjuhën e përdorur në televizionet e vendit, si dhe për ankesat drejtuar KPM-së sa i përket gjuhës së urrejtjes në transmetuesit publik në Kosovë.

Sipas KPM-së, nga monitorimi 24/ 7 që u bëhet transmetuesve të licencuar, mund të thuhet se viteve të fundit niveli i komunikimit publik në televizionet vendore, është përmirësuar relativisht shumë. Ata thonë se më tepër ka raste të përdorimit të gjuhës vulgare, sesa të gjuhës së urrejtjes. Me vite nuk kanë pranuar ankesa për gjuhën e urrejtjes rreth orientimit seksual, bazës fetare, gjendjes martesore, gjendjes shëndetësore -mendore etj. Sa i përket ankesave për përdorim të gjuhës së urrejtjes në televizionet vendore, KPM thotë se nuk ka një sistem të të dhënave, mirëpo të dhëna ka, të cilat i publikojnë përmes raporteve vjetore, ose i ruajnë përmes tabelave të të dhënave për përdorim të brendshëm, e të cilat i kanë vënë në dispozicion edhe për Avokatin e Popullit.

Nga të dhënat e KPM kuptohet se gjatë vitit 2020, KPM-ja ka pranuar vetëm 3 ankesa lidhur me gjuhën e përdorur në televizion. Gjatë vitit 2021, nga 17 ankesa të trajtuara për shkelje të Kodit të Etikës, asnjëra nga to nuk ka të bëjë saktësisht me gjuhën e urrejtjes. Ndërsa, në vitin 2022, KPM-ja pranuar 10 ankesa për shkelje të Kodit të Etikës, por asnjëra për gjuhë të urrejtjes. Mirëpo, në vitin 2022, KPM-ja ka hapur dy raste ex officio ndaj një televizioni me frekuencë lokale, për përdorim të gjuhës së papërshtatshme. KPM-ja ka pohuar se kanë një praktikë veprimi në rastet e paraqitjes së ankesave, qëllimi i tyre nuk është gjithmonë shqiptimi i vërejtjes apo ndëshkimit me gjobë. Sipas tyre, ata fillimisht shkojnë në procedurë pajtimi apo kërkim faljeje nga ana e televizionit për gjuhën e përdorur, e pastaj, kur rasti përsëritet në formën e njëjtë nga televizioni i njëjtë, shqyrtohet opsioni i vërejtjes ose dënimit me gjobë. Për këtë arsye, KPM-ja thotë deri më tani nuk e ka asnjë rast të evidentuar në të cilin është shqiptuar dënimi me gjobë për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga televizionet vendore.

GJUHA NË DISKURSION PUBLIK, SIPAS KËSHILLIT TË MEDIAVE TË SHKRUARA TË KOSOVËS (KMSHK)

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është organ vetërregullues i cili kryesisht merret me zbatimin e Kodit të Mirësjelljes së Mediave të Shkruara të Kosovës, respektivisht Kodit të Etikës. Këshilli ka mbi 40 anëtarë që vijnë nga gazetatat, portalet dhe agjencitë e lajmeve. KMSHK përbëhet nga tre anëtarë të pavarur, të cilët kryejnë funksionin e kryetarit dhe të nënkryetarëve, Sekretaria, si dhe Kuvendi i anëtarëve që përbëhet nga përfaqësuesit e mediave të shkruara të anëtarësuar – kryeredaktorët apo të deleguarit e tyre.

Gjatë harkut kohor që po shqyrton ky raport, KMSHK-ja është marrë me një numër të madh rastesh. Megjithatë, nuk duket se shumë prej tyre paraqesin shqetësime për gjuhën e urrejtjes.

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka pranuar gjashtë ankesa nga palët me shkelje të pretenduara të Kapitullit III (nxitja dhe gjuha e urrejtjes) të Kodit të Mediave. KMSHK ka vendosur të mos i miratojë pesë ankesa, ndërsa një e ka miratuar. Në lidhje me shkrimin e përmendur, KMSHK gjen se publikimi i një opinioni në një portal, nuk është bazuar as në fakte, e as në dëshmi.¹⁰⁷

¹⁰⁶Takimi i zyrtarëve të IAP-it me zyrtarët e KPM është realizuar më 22 shkurt 2023.

¹⁰⁷Gjendet në [vendim KMSHK 1289-2022.pdf \(presscouncil-ks.org\)](https://www.kmsmk.org/ndim/1289-2022.pdf).

Gjatë vitit 2021, KMSHK ka trajtuar 10 ankesa nga palët që pretendonin shkeljen e kapitullit të tretë (nxitja dhe gjuha e urrejtjes) të Kodit të Etikës. Nga ky numër, Këshilli miratoi vetëm dy ankesa, që në thelb ishin të njëjta, por të deponuara nga persona të ndryshëm. Këshilli ka gjetur se dy media online raportuan një artikull duke i përshkruar deputetët si islamikë dhe ankuesi argumentoi se kjo përbënte nxitje urrejtjeje në kundërshtim me Kodin. KMSHK-ja u pajtua që titulli nuk duhej të përfshinte formulimin që kishte.¹⁰⁸

Gjatë vitit 2020, Këshilli kishte trajtuar 12 ankesa që ndërlidhen me pretendimet për shkeljen e kapitullit të tretë (nxitja dhe gjuha e urrejtjes). Shumica e këtyre ankesave nuk janë miratuar nga këshilli. Në disa ankesa, këshilli nuk kishte gjetur komentime të lexuesve në lajmet përkatëse, në disa portale të cilave u janë adresuar ankesat. Vetëm në një rast, KMSHK ka gjetur se është shkelur kapitulli i tretë, tek një medium i cili ka publikuar në vazhdimësi në lidhje me vetëvrasjet në vend. Këshilli ka theksuar se 'mediave u ndalohet të promovojnë veprimet kriminale apo të dhunshme, ku lajme të tilla publikohen vazhdimisht, dhe të përcjella edhe me detaje nga mënyrat e kryerjes dhe fotografitë e personave'¹⁰⁹.

¹⁰⁸ Gjendet në [vendim_KMSHK_1168-2021.pdf \(presscouncil-ks.org\)](#).

¹⁰⁹ Gjendet në [vendim_KMSHK_1078-2021.pdf \(presscouncil-ks.org\)](#).

GJUHA E PËRDORUR NË SEANCA PARLAMENTARE

Detyrimet e deputetëve në dritën e debatit në Kuvendin e Kosovës

Gjuha e përdorur në debatet publike nga politikanët ndikon në masë të madhe te publiku i gjerë sepse e përcakton tematikën dhe tonin e diskursit publik. Politikanët kanë detyrim politik dhe përgjegjësi morale që të përmbahen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës stigmatizuese, dhe për ta dënuar menjëherë dhe pa mëdyshje përdorimin e saj nga të tjerët, pasi heshtja mund të interpretohet si miratim ose mbështetje. Mbrojtja e shtuar e lirisë së shprehjes që ata gëzojnë gjithashtu forcon përgjegjësinë e tyre në këtë fushë.¹¹⁰

Neni 7 i Kushtetutës përcakton se: *"rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë... barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit...drejtësisë sociale". Ngjashëm, Neni 21 i saj parashikon se "të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës".*

Ushtrimin e funksionit të deputetit në interesin më të mirë të vendit e garanton Kushtetuta e Kosovës në nenin 74 të saj: *"deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit".*

Në bazë të nenin 75 të Kushtetutës deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprime ose vendime që janë në kuadër të fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë. Megjithatë, është e rëndësishme që ky nen gjithashtu pranon se imuniteti nuk do të pengojë ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprime jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit.

Për imunitetin e deputetëve, është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin në Rastin. Nr K098/11¹¹¹, kur ka konstatuar se *"Deputetët duhet të jepen të lire për ta ushtruar funksionin e tyre dhe të mos jepen përgjegjës për veprimet, vendimet, votimet dhe mendimet e tyre të shprehura gjatë kohës që janë duke kryer detyrat si deputetë të Kuvendit." Duke shtuar në vijim se "Ata gëzojnë imunitet për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë. Është me rëndësi të vihet në pah se ky privilegj nuk u është dhënë deputetëve për interesin e tyre personal, por të mirën e popullit që e kanë zgjedhur atë. Ky është pasqyrim i domethënies se imunitetit që perfshin veprimet "brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit".*

Rregullorja e Kuvendit të Republikës, në nenin 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të saj përkufizohet gjuha joparlamentare, e cila nënkupton *"përdorimin e fjalëve, shprehjeve dhe sinonimeve, të cilat lëndojnë ose fyejnë dinjitetin e deputetëve dhe personave të tjerë, nxisin urrejtje, mostolerancë dhe dhunë"*¹¹².

Më tutje, në nenin 65 të saj, përcaktohen edhe masat e mundshme që mund të aplikohen nëse përdorët gjuha joparlamentare: *"Kur deputeti ose anëtar i Qeverisë përdor gjuhë joparlamentare, me sjelljen e tij pengon zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin e saj, kryesuesi i seancës plenare i jep "vërejtje", duke*

¹¹⁰ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta 2275(2019), e qasshme në: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=27636>

¹¹¹ https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KO98-11_SHQ_AKTGJYKIM.pdf

¹¹² Neni 2, paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, (hyri në fuqi më 22 korrik 2022) shih në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266>.

deklaruar se është duke përdorur gjuhë joparlamentare." Në rast se vërejtja nuk zbatohet apo përsëritet nga deputetit apo anëtari i qeverisë brenda së njëjtës seancë plenare, kryesuesi i seancës i jep "vërejtje me paralajmërim për largim nga seanca plenare". Në bazë të nenit 66 të kësaj Rregullorje, kryesuesi i seancës mund ta marrë masën e largimit nga seanca plenare për atë ditë kur "deputeti ose anëtari i Qeverisë përdor fjalë fyese, cenon personalitetin e kryesuesit të seancës ose deputetit, ose vazhdon të bëjë shkelje, pasi më parë në të njëjtën seancë janë zbatuar masat tjera". Kjo masë shoqërohet me heqjen e mëditjes së deputetit për atë ditë. Neni 129 i Rregullorës, thotë se: "Kodi i sjelljes për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës është akt i veçantë dhe miratohet nga Kuvendi me propozim të Komisionit përkatës për Rregullore të Kuvendit", deri në Kohën kur ky raport po hartohej Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka nxjerrë Kodin e sjelljes.

Në publikimin e Këshillit të Evropës, për studimin gjithëpërfshirës për gjuhën e urrejtjes dhe perceptimin e saj në Shqipëri¹¹³, jepet një pasqyrë e margjinës së tolerancës, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kur bëhet fjalë për politikanët e zgjedhur, partitë politike, qeverinë etj., dhe për ligjërimin politik dhe gjuhën e urrejtjes. Për më tepër, në interpretimin se deri në ç'masë mund ta mbulojë shprehjen e deputetëve imuniteti parlamentar, studimi në fjalë i referohet çështjes Norwood kundër Mbretërisë së Bashkuar, kur GjEDNJ ka vlerësuar se për të bërë dallimin ndërmjet aktivistëve politik, përfaqësuesve të zgjedhur, partive politike etj., ka përdorur qasjen kontekstuale dhe ka shpjeguar se si e drejta për lirinë e shprehjes formësohet nga natyra e postit që ushtron dhe statusit që gëzon. Më tutje, në referimin të praktika gjyqësore e GjEDNJ në këtë studim¹¹⁴ theksohet edhe vlerësimi i GjEDNJ në Vendimin për çështjen Lingens kundër Austrisë¹¹⁵, në të cilin gjykata ka qartësuar se kur "beteja kundër të gjitha formave të mos-durimit është pjesë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, është me rëndësi kyçe për politikanët, që gjatë ligjërimin të tyre politik të shmangin shprehje që kanë gjasa të nxisin mos-durimin", pra pavarësisht mbrojtjes së fuqishme që i duhet bërë lirisë së shprehjes politike në një shoqëri demokratike liria nuk përfshin dhe nuk mundet të përfshijë "lirinë për të shprehur opinione raciste ose opinione që nxisin urrejtjen, ksenofobinë, antisemitizmin dhe të gjitha format e mos-durimit".¹¹⁶

Të gjeturat nga hulumtimi

Avokat i Popullit ka monitoruar dhe analizuar disa nga seancat parlamentare në Kuvendin e Kosovës në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2022.

Për qëllim të këtij hulumtimi janë përzgjedhur 9 seanca parlamentare, brenda periudhës kohore janar 2020 – mars 2022, në bazë të temës dhe çështjes që është trajtuar, gjuhës që është përdorur dhe interesit që kanë ngjallur në publik.¹¹⁷ Transkriptimi i seancave të mëposhtme ka gjeneruar një korpus të dhënash prej rreth 33,000 fjalësh. Korpusi i të dhënave më pas është analizuar si manualisht, me një qasje cilësore, ashtu edhe automatikisht, nëpërmjet Sketchengine¹¹⁸, përmes fjalëve kyçe

¹¹³ Përtej përkufizimeve, Thirrje kundër Gjuhës së Urrejtjes në Shqipëri, Një studim gjithëpërfshirës, Këshilli i Evropës, nëntor 2021, shih në: <https://rm.coe.int/beyond-definitions-alb/1680a465f8>, faqe 12.

¹¹⁴ Po aty, faqe 12

¹¹⁵ Rasti Lingens Shih në: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57523%22%7D>

¹¹⁶ Po aty, faqe 12.

¹¹⁷ Seancat parlamentare të datave: 3 shkurt 2020 – zgjedhjet në vend; 25 mars 2020 -votimi mosbesimit të qeverisë; 3 qershor 2020- zgjedhjet në vend; 6 maj 2021 – debate për Covid 19; 17 dhe 19 maj 2021 – programi i qeverisë së re; 4 tetor 2022- çështja e veriut; 24 janar 2022- çështja e shtrenjtimit të rrymës dhe 16 mars 2022- Kodi civil.

¹¹⁸ Sketchengine, një menaxher korpusi dhe softuer për analizimin e tekstit i zhvilluar nga Lexical Computing Limited që nga viti 2003 me synimin për të studiuar sjelljen gjuhësore përmes kërkimit të koleksioneve të mëdha tekstesh sipas pyetjeve të motivuara gjuhësisht (www.sketchengine.co.uk).

të përzgjedhura. Nga analizimi i të dhënave del se gjuha e urrejtjes d.m.th. nxitja e drejtpërdrejtë e urrejtjes, nuk është hasur në seancat parlamentare të analizuara.

Megjithëse nuk është hasur nxitje e drejtpërdrejtë e urrejtjes në seancat parlamentare të analizuara, nuk do të thotë se gjuha e urrejtjes mungon plotësisht në transkriptimin e seancave. Në fakt, forma e shprehjes që nuk mund të përcaktohet si vepër penale, ose ajo që ne e kemi quajtur gjuhë e butë e urrejtjes¹¹⁹, shfaqen disa herë, dhe po aq sa fyerjet drejtuar politikanëve/partive politike dhe etiketime për kriminalizimin e kundërshtarëve politikë (“Hajdutë”, “Kriminelë”, “Banditë”). Një fjalë shumë e shpeshtë është edhe “Vjedhja” e cila pasohet me fjalët “korrupsion”, “krim”, “shantazh” për të përforcuar konceptin dhe për të theksuar sjelljet e pretenduara “kriminale”. Edhe pse kjo mund të mos konsiderohet si një shembull i gjuhës së urrejtjes e dënueshme sipas ligjit, sigurisht që mund të shihet si një shembull i shpifjes, një veprim i cili përfshihet në përkufizimin më të gjerë të gjuhës së urrejtjes, ***pasi duke dëmtuar reputacionin e personit të synuar ose grupit të njerëzve mund të shkaktojë urrejtje ndaj tyre*** (siç tregon analiza e emisioneve të debatit televiziv: 27% e komenteve të gjuhës së urrejtjes kanë të bëjnë me bindjet politike, shih Fig 4.).

Në grupin e të dhënave të këtij hulumtimi del se *shpifja* e mbështetur me argumente ose jo, është mjaft e përsëritur si një formë sulmi dhe një shkaktar i mundshëm i gjuhës së urrejtjes. Për shembull, një nga narrativat kryesore të grupeve parlamentare është akuzimi i qeverisë për kontrabandë, vjedhje dhe “lakmi”, “shkaktimi i degjenerimit”, nxitje të “korrupsionit”, “nepotizmit”, “servilizmit”, “klientelizmit”, “mungesës së dinjiteti njerëzor”, të qenët i lidhur me “mafia” etj., dhe njëra akuzë mund t’i shtohet tjetrës për hir të theksimit dhe efektit retorik.

Së bashku me shpifjen, delegjitimimi dhe heshtja janë strategji të tjera jo vetëm për të sulmuar, por edhe për të pakësuar kundërshtarin (“është e turpshme mënyra se si flisni”). Opozita akuzohet shpesh për manipulim të opinionit publik, për ndjekje të “logjikës mercenare”, për “shantazh”, për “linçim dhe aktivizim të linçimit ndaj deputetëve”, për heqje dorë “grusht shtet” përmes “mercenarëve mediatikë”. Mallkimi dhe fyerja edhe pse nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite, kjo tregon një perceptim që patjetër do të meritonte hetim të mëtejshëm.

Presupozimet dhe nënkuptimet bisedore - d.m.th., supozimet përkatëse të nënkuptuara në lidhje me besimin e kontekstit në lidhje me një thënie, e vërteta e së cilës merret si e mirëqenë dhe kuptimet që folësi sugjeron ose nënkupton me një thënie, edhe pse ato nuk shprehen fjalë për fjalë, mund të jenë një mënyrë tjetër për t’ia drejtuar gishtin në mënyrë implicite sjelljeve të pahijshme dhe për të nënkuptuar përgjegjësi afatgjata, pra edhe këto hyjnë në grupin e të dhënave si një formë sulmi dhe një shkaktar i mundshëm i gjuhës së urrejtjes.

Edhe pse çështjet e ndjeshme politike lidhur me përbërjen politike dhe etnike të Kosovës ishin në thelb të disa seancave parlamentare, në veçanti të seancës për “Çështjen e Veriut” (4 tetor 2021), nuk ka asnjë gjurmë të fyerjeve apo stereotipeve etnike në transkriptet e seancave të analizuara. Por në transkriptimin e debatit për Projekt Kodin Civil dhe futjen në legjislacion të martesës së të njëjtit seks janë shumë të qarta fyerjet, shpifjet dhe gjuha indirekte e urrejtjes.

¹¹⁹ Shih më sipër në këtë Raport, faqe 11,12 dhe 13.

Në këtë rast është me rëndësi të sqarohet se në raport nuk janë paraqitur emrat e deputetëve dhe diskutimet e tyre në këto seanca, për dy arsye;

- e para raporti nuk synon ta analizoj gjuhën e përdorur në kotesktin individual, sepse kjo do ta kufizonte vet qëllimin e raportit;
- e dyta të gjitha analizat janë vlersuar nga traskriptet e seancave të cilat janë publik. Përveq kësaj theksi është vendos tek përmbajtja e gjuhës, efekti që ka pas në publik dhe në nxitjen e komenteve nga publiku si dhe pozita e folësit, e jo te personi.

Në këtë rast, “detyrimet abstrakte” të Kodit të Sjelljes duket se janë marrë përsipër me argumente në favor të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe pa e përfillur opinionin publik për të drejtat e personave LGBTI.

Gjuha e përdorur ndaj personave LGBTI

Projekt Kodi Civil nuk ishte krejtësisht i panjohur për qytetarët, pasi në diskursin publik është diskutuar që nga viti 2014. Në gusht të vitit 2020, pasi Projekt Kodi Civil u miratua nga Qeveria, u dërgua në Komisionin Parlamentar për Legjislacion¹²⁰. Megjithatë, në mungesë të kuorumit, nuk u votua në vitin 2020. Derisa në mars të vitit 2021, projekt kodi u rikthye në Ministrinë e Drejtësisë për shqyrtim. Versioni i fundit i tij, u miratua më 29 dhjetor 2021 dhe përfundimisht u soll për debat në Kuvend më 16 mars 2022¹²¹.

Në këtë seancë, deputetëve të Kuvendit të Kosovës iu kërkua të votojnë pro/kundër dokumentit të plotësuar të Kodit Civil që trajton, ndër të tjera, bashkësitë civile të të njëjtit seks (neni. 1138, para. 2 “*Bashkësitë e regjistruara ndërmjet personave me sekse të njëjta janë të lejuara. Kushtet dhe procedurat rregullohen me ligj të veçantë*”). Ky nen i këtij kodi, nga sa është vërejtur nga mediet dhe platformat sociale, hasi në kundërshtim nga një numër i madh qytetarësh si dhe nga disa deputetë dhe në fund u refuzua. Nga 77 deputetë të pranishëm në seancën e Kuvendit, 28 votuan pro, 29 kundër, 4 abstenuan dhe 16 nuk votuan fare. Një nga arsyetimet kryesore që deputetët ngritën për të kundërshtuar projekt-kodin e propozuar ishte se bashkësitë civile të të njëjtit seks përbënin një kërcënim për ruajtjen e institucionit të familjes.

Para diskutimit parlamentar, disa deputetë u paraqiten në publik me deklarata dhe pohimet e tyre se pse nuk duhet të votohej pro Projekt Kodit Civil. Këto qëndrime kanë prodhuar komente negative në mediat sociale dhe në opinionin publik, të cilat më tej shpërfaqën narrativet dhe qëndrimet homofobike, duke minuar kështu të drejtat e barabarta të individëve në opinionin publik.

Deklaratat e disa deputeteve në rrjetet e tyre sociale, gjeneruan shumë komente të mbushura me gjuhë urretjeje. Komente të tilla si “[LGBTI] janë njerëz të sëmurë” dhe “Unë do t’i varja këta njerëz në mes të sheshit”, e që do të mund të rezultonin me nxitje të dhunës. Në të njëjtën periudhë, disa postime negative dhe homofobike u përhapën edhe në internet përmes Facebook-ut, duke i bërë thirrje publikut t’i “thotë jo Kodit Civil, i cili legjitimon martesën e të njëjtit seks dhe rrezikon familjen dhe kombin,

¹²⁰ Emri i plotë: Komisioni për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

¹²¹ Lidhur me Projekt Kodin Civil, Avokati i Popullit i kishte dërguar Ministrisë së Drejtësisë, Opinionin Ex. Officio nr. 307/2022 lidhur me njohjen e marrëdhënieve familjare të personave me sekse të njëjta me Projektkodin Civil. I qasshëm në: <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/05/Opinion-307-2022.pdf>

në emër të Zotit dhe të kombit". Mes komenteve mund të lexohej "nuk mund të jesh homoseksual dhe patriot. Ose je me shqiptarët, fenë, dhe traditën, moralin dhe njerëzimin, ose je armiku i tyre".

Në seancën e 16 marsit 2022, deklaratat negative ndaj personave LGBTI vazhduan dhe u shprehën me zë nga disa deputetë, të cilët jo vetëm që mund të avokonin hapur për "familjen natyrore" dhe "ruajtjen e specieve" dhe "traditave", por edhe të verbalizonin përmbajtje paragjyquese kundër çifteve të të njëjtit seks. Sipas disa deputetëve, Kodi i ri do të rrezikonte "moralin publik" dhe do të prezantonte "pangopësinë seksuale", "degjenerimin moral", "sëmundjen", "shthurjen", sjelljet "në kundërshtim me natyrën njerëzore", "shkeljen e shenjtërisë së familjes" përbën një veprim që dëmton rëndë shëndetin publik, duke u bërë shkak i sëmundjeve të rënda dhe të pashërueshme, si HIV/AIDS", dhe në fund të fundit rezulton me traumën sociale".

Organizatrat e shoqërisë civile kanë reaguar kundër gjuhës së përdorur ndaj komunitetit LGBTI në debatin për projekt kodin civil. Në reagimet e tyre kanë theksuar se, diskriminimi dhe stigma sociale dëmtojnë mirëqenien psikologjike, fizike, sociale dhe ekonomike të personave LGBTI.¹²² Po ashtu kanë adresuar kritika ndaj Qeverisë për heshtjen dhe mos dënimin e përhapjes së gjuhës së urrejtjes në institucione dhe forma publike.¹²³ Ndër të tjera, organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet letrave drejtuar deputetëve dhe palëve të tjera të interesit kanë bërë thirrje që të veprojnë sipas Kushtetutës së Kosovës dhe t'i japin fund përjashtimit nga martesat të çifteve të të njëjtit seks.¹²⁴ Organizatat e shoqërisë civile i janë drejtuar me thirrjen e njëjtë edhe Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Kosovës, Ministrit të Drejtësisë dhe të gjithë deputetëve të Kuvendit, duke ua kujtuar atyre se "*Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh kufizime gjinore në lirinë për t'u martuar... dhe ndalon diskriminimin në bazë gjinie, orientimi seksual apo status tjetër personal*".¹²⁵

¹²² Fakulteti Filozofik, Deklaratë, https://filozofiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,35,1390&fbclid=IwAR0o-L8WRhM7a_nosnHkakBBf-oG49f582EjMTY6hBnfl_MQBny0gpsJGDA.

¹²³ Shih <https://kosovotwopointzero.com/en/we-dont-know-what-its-like-to-be-free/>; shih edhe <https://cel-ks.org/en/>.

¹²⁴ Shih <https://www.lgbti-era.org/news/letters-support-civil-society-organizations-and-human-rights-defenders-western-balkans-and>.

¹²⁵ Shih https://www.hrw.org/sites/default/files/media_2022/03/Letra_e_martesës_në_Kosovë_3.16.22_për_Web_0.pdf.

GJUHA NË DISKURSION MEDIATIK

Mediet kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturës demokratike, sepse ato shpërndajnë informata që kanë ndikim të jashtëzakonshëm në formësimin e mendimeve të masës dhe mënyrën se si qytetarët i shohin proceset e ndryshme. Ato gjithashtu janë platformë që gjeneron debate, përmes lajmeve dhe tematikave që zgjedhin t'i publikojnë. Rrjedhimisht, ato duhet të jenë të lira dhe të pavarura dhe në mënyrë vullnetare të marrin përgjegjësi sociale. Nëse ato lejojnë që brenda fushëveprimtarisë së tyre të këtë edhe forume ku qytetarët ushtrojnë lirinë e shprehjes së tyre, ato në të njëjtën kohë duhet të marrin edhe përgjegjësinë që të sigurohen se debatet e transmetuara përmes tyre, nuk nxisin gjuhë të urrejtjes dhe dhunë me bazë urrejtje, duke shkelur dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve.

Luftimi i gjuhës së urrejtjes duke e siguruar edhe lirinë e mediave, është çështje mjaft komplekse që kërkon analizim të thuktë. Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës¹²⁶ përcakton rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (OSHM). Ky Kod lidhur me nxitjen e urrejtjes, në nenin 5 përcakton se: *“OSHM-të nuk duhet të nxisin ose promovojnë, qëllimisht ose në mënyrë indirekte, cilëndo nga format e diskriminimit dhe jo tolerances dhe nuk duhet të transmetojnë asnjë material që njollosë një grup etnik apo fetar, apo që nënkupton se një grup etnik apo fetarë është përgjegjës për aktivitete kriminale.”* Në tutje liston bazat e mbrojtura në pajtueshmëri me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe përcakton se: *“OSHM-të gjatë transmetimit të përmbajtjes nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcenimit të një individi apo grupi në bazë të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, moshës apo paaftësisë fizike ose mendore.”* Për më tepër, ato *“...nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtjen dhe pabarazinë dhe që mund të rezultojnë me veprime kriminale dhe të dhunshme kundër një individi apo grupi.”* Ndërsa në nenin 11 të tij përcaktohen sanksionet të cilat aplikohen bazuar në Ligjin e Komisionit të Pavarur për Media dhe në raste të veçanta, *“kur një OSHM përmes programit të vet nxit veprime që çenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme, KPM do të urdhërojë OSHM-të që menjëherë ta nderpres transmetimin e përmbajtjeve të tilla, i cili mund të rezultojë më ndërprerje të licencës së OSHM-së.”*

Debatet televizive

Për qëllim të këtij hulumtimi, si dhe për të eksploruar format e gjuhës së papërshtatshme, diskriminuese, paragjyquese dhe të urrejtjes në diskursin mediatik janë mbledhur dhe analizuar të dhënat nga debatet televizive dhe komentet që ato kanë gjeneruar nga ndjekësit në rrjetet sociale.

Për debatet televizive, grupi i të dhënave është krijuar duke u nisur nga të dhënat e seancave parlamentare, për të parë se si komentohej dhe raportohej diskursi parlamentar në diskursin mediatik. Monitorimi i mediave është kryer në muaj të ndryshëm nga viti 2020 deri në vitin 2022, përkatësisht monitorimi i emisioneve të debateve televizive në tri medime të ndryshme, *Debat Plus*, *Pressing*, dhe *Rubikon*, të cilat u zgjodhën në bazë të numrit të audiencës së tyre¹²⁷. Gjatë kësaj periudhe janë analizuar 23 debate televizive: 17 janë mbledhur përmes faqeve të emisioneve në Facebook, ku janë transmetuar drejtpërdrejt, ndërsa 6 janë mbledhur nga kanalet televizive në YouTube. Mostra përfshinte edhe një emision televiziv në gjuhën serbe, *Slobodno Srpski*, por nuk është hasur në komente në faqen e emisionit në Facebook për datat e përzgjedhura.

¹²⁶ Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 5 dhe 11, i qasshëm në: <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>

¹²⁷ Këto të dhëna u mbledhën përmes Crowdtangle – Page Followers, 1 shkurt 2022

Të dhënat nga monitorimi paraqiten si të dhëna të përmbledhura për të gjitha programet e debatit televiziv, pasi qëllimi kryesor i studimit është të ofrojë një pasqyrë të përmasave dhe llojit të gjuhës së papërshtatshme, diskriminuese, paragjyquese dhe të urrejtjes në diskursin publik.

Të dhënat për analizën e përmbajtjes përfshijnë gjithsej 12,581 komente nga 17 debate televizive të drejtpërdrejta të transmetuara drejtpërdrejt në faqet e emisioneve në Facebook, në periudhën nga janari 2020 deri në mars 2022. Këto komente janë shkruar nga qytetarët si vazhdim i debateve televizive dhe mund të jenë si komente të drejtpërdrejta për temat e trajtuara gjatë emisionit, ashtu edhe komente për komente të tjera. (shih fig.1.)

	Numri i emisioneve	Numri i transmetimit të drejtpërdrejtë	Numri i shikimeve në kohën e transmetimit të drejtpërdrejtë	Numri i komenteve	Numri i pëlqimeve	Numri i shpërndarjeve
RUBIKON	5	3	21,284	450	157	7
DEBAT PLUS	9	7	156,86	4585	1343	42
PRESSING	9	7	412,480	7546	5583	578

Figura 1. Numri i transmetimeve të drejtpërdrejta, komenteve, pëlqimeve dhe shpërndarjeve të mbledhura nga faqet në Facebook të Rubikon, Debat Plus dhe Pressing

Figura 2. tregon se ka një ndryshim statistikisht domethënës në sasinë e shprehjeve të përdorura dhe gjuhës së urrejtjes, ndërmjet viteve të analizuara. Kjo tregohet edhe në Figurën 2, e cila ndau 100% të komenteve të shprehjeve të përdorura dhe gjuhës së urrejtjes, në emisionet e analizuara të debatit televiziv.




Figura 2. Përqindja e komenteve të gjuhës së urrejtjes. Rubrika "Total" bazohet në 12,581 komente në Facebook të marra nga faqet në Facebook të Rubikon, Debat Plus dhe Pressing. Rubrika "2020" bazohet në 9,109 komente nga faqet të Facebook-ut të tri emisioneve televizive me debate. Rubrika "2021" bazohet në 2074 komente nga faqet të Facebook-ut të tri emisioneve televizive me debate. Rubrika "2022" bazohet në 1298 komente nga faqet të Facebook-ut të tri emisioneve televizive me debate.

1,692 nga 12,581 komentet në rrjetin social Facebook që janë analizuar janë kategorizuar si gjuhë urrejtjeje, sipas kriterëve të parashikuara në hyrje. Kjo do të thotë se komente me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes janë gjetur në 1 nga 7 komente të postuara në datat e zgjedhura në faqet në Facebook të të 3 emisioneve televizive në të tri mediumet e monitoruara. Kjo po ashtu nënkupton se individë ose grupe ishin shënjestër e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në 13% të rasteve, që është vërtet një përqindje e konsiderueshme.




Figura 3. Përqindja në 1,692 komente me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në faqet e emisioneve televizive në Facebook

Shumica e komenteve lidheshin me temat e debatuar në emisione; 31 komente nga 1,692 janë shkruar me shkronja të mëdha, që mund të jetë tregues i zemërimit¹²⁸. Disa komente ishin raste të qarta të turpërimit të trupit dhe disa përfshinin edhe kërcënime me vdekje ndaj aktorëve politikë.

Kategoritë e komenteve të gjuhës së përdorur në rrjetin social Facebook

Komentet e gjuhës së përdorur janë ndarë në tetë kategori, të zgjedhura nga kategoritë e theksuara në Hyrje për rëndësinë dhe relevancën sasiore brenda korpusit të të dhënave: besimi politik, përkatësia etnike, feja, metaforat çnjerëzore, orientimi seksual, paaftësia, mallkimi dhe të tjera. Disa komente janë vendosur në më shumë se një kategori, duke rezultuar në gjithsej 1,803 raste të gjuhës së urrejtjes. Këto janë raste të qarta të “gjuhës së urrejtjes ndërseksionale”¹²⁹, të cilat mund të kombinojnë, për shembull, vërejtje nënçmuese mbi bindjet politike dhe seksualitetin.

¹²⁸ Shih Gómez-Zaragozá, Lucía dhe Sara Hinojosa Pinto, *Profilizimi i përhapësve të gjuhës së urrejtjes në Twitter duke përdorur veçori stilistike dhe futje fjalësh*, CLEF (2021).

¹²⁹ Shih Projektin SCAN, *Gjuha ndërseksionale e urrejtjes në internet*, http://scan-project.eu/wp-content/uploads/sCAN_intersection-al_hate_final.pdf.




Figura 4. Përqindja e komenteve të gjuhës së urrejtjes e ndarë në tetë kategori, bazuar në 1,692 komente në rrjetin social Facebook.

Nëse shikojmë katër kategoritë kryesore të gjuhës së urrejtjes (besimi politik, aftësia e kufizuar, metaforat çnjerezore dhe përkatësia etnike) gjejmë disa të dhëna interesante.

Komentet që synojnë njerëz ose grupe njerëzish për bindjet e tyre politike janë 459 nga 1,692, (27% e totalit). Në këtë kategori përfshihen shprehjet nënçmuese drejtuar partive apo politikanëve, si "hajdutë", "komunistë", "diktator" etj. Vërejtje të tilla iu drejtuan një game të gjerë politikanësh; komente urrejtjeje ndaj partive më të vjetra politike¹³⁰ janë mbizotëruese.

Komentet në lidhje me aftësitë e kufizuara janë kategoria e dytë më e madhe: 244 komente, pra 14% e totalit. "Hajvan", "belbëzues", "debil", "i verbër", "analfabet" etj., ishin disa nga shprehjet që u gjetën në analizën e të dhënave.

Numri i tretë më i madh i komenteve me urrejtje (220 komente, pra 13%) ka të bëjë me metaforat çnjerezore, si "dele", "Lopë", "Qen", "Majmun", "Gjarpër".

Gjuha e urrejtjes që synonte përkatësinë etnike ishte 8% e totalit të komenteve me urrejtje. Njerëzit përdornin fjalë nënçmuese për t'iu referuar serbëve ose grupeve të tjera etnike, edhe pse objekti i fyerjes ishte përgjithësisht një qytetar i përkatësisë etnike shqiptare.

Disa kategori kishin një përqindje më të vogël të gjuhës së urrejtjes, ndërsa 23% e komenteve u kategorizuan si "të tjera", që është numri i dytë më i madh i komenteve me urrejtje. Kjo kategori përfshin shprehje si "kriminel", "njeri i poshtër", "mercenar", "plehra", "vrasës", "malok", "banditë", "person i korruptuar", "spiun", "varr", "shkatërrues i vendit", etj., pra profesionet dhe tiparet morale të konotuara negativisht.

¹³⁰ "Partitë e vjetra" është një shprehje e përdorur zakonisht në Kosovë për të treguar partitë politike që u krijuan gjatë viteve të 90-ta dhe në fillim të vitit 2000.

Në 7% të komenteve të gjuhës së urrejtjes në shënjestër kishin seksualitetin dhe kryesisht kishin të bënë me orientimin seksual. Ndërsa, 3% ishin komente me urrejtje që përmbanin mallkime kryesisht kundër politikanëve, por ndonjëherë edhe ndaj mysafirëve të emisioneve televizive. Vlen të theksohet se fyerjet e bazuara në fe janë shumë të rralla, më pak se 1%.

Gjuha në debatet televizive

Komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes nuk janë vetëm rezultat i komenteve të tjera në transmetimin e drejtpërdrejtë të debatit në Facebook, ato lidhen drejtpërdrejt me temën që debatohet nga të ftuarit në emisionet e debatit televiziv. Të dhënat tregojnë se kur gjuha e papërshtatshme, diskriminuese, fyese apo e urrejtjes, përdoret nga mysafiri i ftuar në emision, ka probabilitet të lartë që komentet e njerëzve në Facebook mund të përmbajnë gjuhës të urrejtjes (52%), ndërsa 48% probabiliteti që komentet të përmbajnë gjuhë të urrejtjes kur nuk janë përdorur shprehje të papërshtatshme apo gjuhë të ashpër.



Figura 5. Gjuha e përdorur në debat televiziv e shprehur në përqindje, sipas faktit nëse diskutimi nga të ftuarit në emision përmban (52%) ose jo (48%) gjuhë të pa përshtatshme.

Nga 1,692 komente të përgjithshme me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, 1,308 (77.3%) u shkaktuan nga gjuha e ashpër/papërshtatshme e përdorur nga mysafirët gjatë debateve televizive. Kjo tregon qartë se nëse në debatet televizive përdoret gjuhë e ashpër/papërshtatshme, shikuesit kanë më shumë gjasa të postojnë komente urrejtjeje në faqet e Facebook-ut kur debati transmetohet drejtpërdrejt.




Figura 6. Gjuha e përdorur në debat televiziv e shprehur në përqindje, kur komentet e përdoruesve të Facebook-ut ishin të lidhura ose jo me diskutimin e të ftuarve në emision

Autorët dhe objektivat e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes

Bazuar në emrat e përdoruesve dhe fotot e profilit, është kryer edhe një analizë gjinore. Kjo analizë ka marrë parasysh faktin se profilet e përdoruesve të Facebook-ut nuk janë të vërtetuara dhe përcaktimi i gjinisë së përdoruesve nuk është gjithmonë i lehtë. Ishte gjithashtu e vështirë ndonjëherë të përcaktohej nëse profilet ishin apo jo të rreme apo të vërteta.

Të dhënat tregojnë një ndryshim domethënës midis burrave dhe grave, ndërkohë që rreth 5% e përdoruesve u klasifikuan si të paidentifikuar sepse nga emri dhe fotografia e tyre e profilit nuk ishte e lehtë të konstatohej gjinia e tyre. Sipas klasifikimit tonë, 86% e komenteve me përmbajtje të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes janë postuar nga burrat, ndërsa 9.3% e tyre janë postuar nga femrat. Shumica e komenteve në grupin e të dhënave janë shkruar nga burra, gjë që shpjegon mbipërfaqësimin të tyre si autorë të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes.




Figura 7. Përqindja e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, kategorizuar sipas gjinisë së përdoruesve të Facebook-ut.

Komentet në rrjetin social Facebook, u analizuan gjithashtu për të parë se kë synonin në mënyrë specifike. Kishte një tendencë të komenteve me urrejtje që synonin kryesisht personat publikë, p.sh. liderë politikë, politikanë në përgjithësi, apo analistë të ftuar në debate televizive (68% e totalit të komenteve me urrejtje). Ndërkohë, 22% synonin një grup, p.sh. partitë politike, grupet etnike, etj., me një shtesë prej 8.8% që synon si grupet ashtu edhe individët. Në përgjithësi, gjuha e urrejtjes synon persona të caktuar në 8 nga 10 raste dhe grupe njerëzish në 3 nga 10 raste.




Figura 8. Përqindja e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes të kategorizuar sipas objektivit të komentit

Gjuha e përdorur kundër personave LGBTI: diskursi në media

Diskutimi në seancë parlamentare të mbajtur më 16 mars 2022, lidhur me Projekt Kodin Civil për futjen në legjislacion të martesës së të njëjtit seks, ishte tema kryesore në debatin televiziv në njërin nga tri emisionet e tri medimeve vendore, të monitoruara për qëllim të këtij raporti. (Ky diskutim parlamentar ishte tema kryesore në debatin televiziv *Debat Plus*, ndërsa në emisionet e tjera debatuese nuk është debatuar, *Pressing* dhe *Rubikon*, e cila nuk u transmetua në atë datë).

Komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes lidhur me temën e debatit në këtë emision në shumicën e rasteve kishin të bënin me gjininë dhe orientimin seksual, si p.sh. "peder", *bulash* (përçmuese), *dylber* (përçmues), ligji i 'bulashit', njerëz të smut, etj. Komentet e tjera u përqendruan në metaforat çnjerëzore: "Majmun", "lopë", "qen", *papagall*, dhe në ato përçmuese: "i poshtë", "psikopat", "idiot" etj. Kishte gjithashtu komente që përmbanin mallkime. Shumica e komenteve iu drejtuan mysafirëve të debateve televizive që ishin në favor të modifikimit të Kodit Civil dhe përmbanin raste të gjuhës me përmbajtje të emrave me konotacione pezhorative.

GJUHA NË PLATFORMAT E MEDIAVE SOCIALE TË KOSOVËS

Të gjeturat lidhur me gjuhën e përdorur në platformat e mediave sociale

Interneti dhe teknologjia e kanë ndryshuar mënyrën e komunikimit dhe shpërndarjes së informatave. Rol në rritje kanë po ashtu platformat e mediave sociale, të cilat gjejnë përdorim masiv në Kosovë, kjo për shkak të strukturës relativisht të re demografike që ka popullsia e Kosovës. Mbetet shqetësues fakti se aktualisht ka fare pak moderim të përmbajtjes që shpërndahet në mediat sociale dhe komentet që gjenerohen nga ndjekësit e këtyre faqeve.

Për të eksploruar shembuj të komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në platformat e mediave sociale, janë mbledhur komentet nga faqet në Facebook të katër mediave online, - "Gazeta Express", "Telegrafi", "IndeksOnline", dhe "Kosovo Online". Përzgjedhja e këtyre katër mediave online, është bërë në bazë të numrit të ndjekësve.¹³¹

Pra, për të parë se si komentohej dhe raportohej në diskursin e mediave sociale, të dhënat janë mbledhur duke u nisur nga të dhënat e seancave. Monitorimi i mediave sociale u ndërmor në muaj të ndryshëm nga viti 2020 deri në vitin 2022. Mediat online të përzgjedhura në gjuhën shqipe ishin: "Gazeta Express", "Telegrafi", dhe "IndeksOnline", ndërsa "Kosovo Online" në serbisht. Në harkun kohor të dhënë, janë përzgjedhur dhe analizuar 43,511 komente për 313 postime lajmesh.




Figura 9. Numri i postimeve të lajmeve në mostrën e analizës

Nga 43,511 komente, 3,043 janë kategorizuar si komente me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes. Kjo do të thotë se në çdo pesëmbëdhjetë (15) komente (7% e totalit) gjuha e urrejtjes është hasur në një (1) koment.

¹³¹ Të dhënat u mblodhën duke përdorur Crowdtangle, 01 shkurt 2022

Data	Gjithsej postime të lajmeve	Gjithsej postime të lajmeve të analizuara	Gjithsej komente	Numri i komenteve me gjuhës të urrejtjes
03 shkurt 2020	389	47	3487	412
25 mars 2020	513	42	10.476	639
03 qershor 2020	584	42	6518	463
06 maj 2021	557	28	6989	218
17&19 maj 2021	999	61	3226	368
04 tetor 2021	249	27	1734	317
24 janar 2022	404	28	2489	161
16 mars 2022	479	38	8592	465
T O T A L I	4174	313	43511	3043

Figura 10. Të dhëna për analizën e përmbajtjes. Numri i postimeve dhe komenteve të mbledhura nga faqet në Facebook të Gazeta Express, Telegraf, IndeksOnline dhe KosovoOnline

Shumica dërmuese e komenteve (93%), nuk u klasifikuan si komente me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes. Ndërsa, 7% e diskursit publik online në katër faqet në Facebook përmbanin komente urrejtjeje që synonin individë ose grupe.¹³²




Figura 11. Përqindja e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në katër faqet në Facebook, të mediave online të monitoruara.

¹³² Rubrika "Total" bazohet në 43,511 komente në Facebook të marra nga faqet e Facebook-ut të Rubikon, Debat Plus dhe Pressing. Rubrika "2020" bazohet në 20,481 komente nga katër faqet e Facebook-ut të mediave online. Rubrika "2021" bazohet në 11,949 komente nga katër faqet e Facebook-ut të mediave online. Rubrika "2022" bazohet në 11,081 komente nga katër faqet e Facebook-ut të mediave online.

Kategoritë e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, në faqet e Facebook-ut të medimeve të monitoruara

Komentet janë ndarë në tetë kategori, të zgjedhura nga kategoritë e theksuara në Hyrje për rëndësinë dhe relevancën e tyre sasiore brenda korpusit të të dhënave: *besimi politik, përkatësia etnike, feja, metaforat çnjerëzore, seksualiteti, paaftësia, mallkimi dhe të tjera*. Disa komente kanë përmbajtje të elementeve të më shumë se një kategorie, duke rezultuar pastaj në gjithsej 3,717 komente me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes nga gjithsej 3,043 komente. Këto mund të jenë komente që synojnë në të njëjtën kohë edhe përkatësinë etnike edhe fenë, për shembull. Shumica e 3,717 komenteve hyjnë në tri kategori: metafora çnjerëzore, bindje politike dhe aftësi të kufizuara. Ka pasur 913 komente (25% e të gjitha komenteve) në të cilat përdoruesit kanë përdorur metafora të lidhura me kafshët, metaforat bimore, etj. Bindjet politike dhe aftësia e kufizuar janë në shënjestër të barabartë dhe gjerësisht (24%). Seksualiteti dhe përkatësia etnike janë shënjestruar shpesh, ndërsa mallkimi ose feja mezi mund të kategorizohen.




Figura 12. Përqindja e komenteve me përmbajtje të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes e ndarë në tetë kategori, bazuar në 3,043 komente përfshirë komentet me më shumë se një kategori.

Nëse shikojmë katër kategoritë kryesore të gjuhës së urrejtjes (metafora çnjerëzore, besimi politik, aftësia e kufizuar dhe seksualiteti) gjejmë informacione më të hollësishme.

Metaforat çnjerëzore, si "lopë", "kali", "majmun", etj. ishin shumica e 3,717 komenteve duke përfshirë komentet me më shumë se një kategori.

Numri i dytë më i madh i komenteve me urrejtje trajton bindjet politike (889 komente, d.m.th. 24% e totalit), dhe veçanërisht në shënjestër ish-partitë qeverisëse ose liderët e tyre aktualë dhe të mëparshëm.

Komentet që lidhen me aftësitë e kufizuara janë 24% e totalit (886 komente), "i çmendur" dhe "i krisur" janë disa nga shprehjet nënçmuese më të njohura që janë gjetur gjatë analizës.

Gjuha e urrejtjes në lidhje me seksualitetin është gjetur në 10% të komenteve. Kjo e dhënë ishte veçanërisht e dukshme në komentet pas seancës parlamentare të 16 marsit 2022, kur u diskutua për çështjen e martesave të të njëjtit seks.

23% e komenteve u kategorizuan si “të tjera”, që përfaqëson numrin e katërt më të madh të komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes. Kjo kategori përfshin shprehje si “kriminel”, “njeri i poshtër”, “mercenar”, “plehra”, “vrasës”, “malok”, “banditë”, “person i korruptuar”, “spiun”, “varr”, “shkatërrues i vendit”, etj.

7% e komenteve të gjuhës së urrejtjes synonin përkatësinë etnike, dhe kryesisht përfshinin emra me konotacion poshtërues për shqiptarët ose serbët. Fyerjet etnike janë më të përhapura në “Kosovo Online” sesa në portalet shqipfolëse. 2% e komenteve përmbanin mallkime të drejtuara më shpesh ndaj politikanëve, por ndonjëherë edhe si përgjigje ndaj komenteve të tjera. Vlen të përmendet se feja është shumë rrallë në shënjestër: vetëm 31 komente në total, dhe 28 prej tyre u gjetën në një datë të vetme, 16 mars 2022.

Autorët dhe objektivat e komenteve

Bazuar në emrat e përdoruesve dhe fotot e profilit, është kryer edhe një analizë gjinore. Kjo analizë ka marrë parasysh faktin se profilet e përdoruesve të Facebook-ut nuk janë të vërtetuara dhe përcaktimi i gjinisë së përdoruesve nuk është gjithmonë i lehtë. Ishte gjithashtu e vështirë ndonjëherë të përcaktohe nëse profilet ishin apo jo të rreme apo karrem.

Të dhënat tregojnë një ndryshim domethënës midis burrave dhe grave, ndërkohë që rreth 6% e përdoruesve u klasifikuan si të paidentifikuar sepse nga emri dhe fotografia e tyre e profilit nuk ishte e lehtë të konstatohej gjinia e tyre. Sipas klasifikimit të këtij hulumtimi, 83.4% e komenteve të gjuhës së urrejtjes janë postuar nga burrat, ndërsa 10.4% e tyre janë postuar nga gratë. Shumica e komenteve në grupin e të dhënave janë shkruar nga burra, gjë që shpjegon mbipërfaqësimin të tyre si autorë të gjuhës së urrejtjes.




Figura 13. Përqindja e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes të kategorizuar sipas gjinisë së përdoruesve të Facebook

Këto komente u analizuan gjithashtu për të parë se kë synonin në mënyrë specifike. Kishte një tendencë të komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes që synonin kryesisht personat publikë, p.sh. liderë politikë, politikanë në përgjithësi, apo analistë/të ftuar në debate televizive (60% e totalit të komenteve me urrejtje). Ndërkohë, 28.4% synonin një grup, p.sh. partitë politike, grupet etnike, etj., me një shtesë prej 7.8% që synon si grupet ashtu edhe individët. Rreth 4% e komenteve janë mes përdoruesve të Facebook-ut. Në përgjithësi, komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes synonin persona të caktuar në 6 nga 10 raste dhe grupe njerëzish në 3 nga 10 raste.




Figura 14. Përqindja e komenteve me përmbajtje të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes të kategorizuar sipas objektivit të komentit

Nëse krahasojmë faqet (portalet) e përzgjedhura të katër medieve online në Facebook, vërehet një ndryshim i dukshëm në objektivat e komenteve të faqes në facebook të mediumit online në gjuhën serbe në krahasim me tri portalet e tjera. Në portalin në gjuhën serbe, pothuajse 40% e komenteve synonin një grup, që është pothuajse dyfishi në krahasim me shifrat e treguara nga analiza e 3 medieve në shqip. Ky rezultat mund të shpjegohet me faktin se tema kryesore e komenteve në faqen e Facebook-ut të mediumit në gjuhën serbe ka të bëjë me marrëdhëniet etnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Në media të tjera online, komentet shpesh synonin figura publike (67% e totalit të komenteve).

Titujt e lajmeve

Lajmet e postuara në Facebook nga mediat u shqyrtuan në mënyrë specifike, për të parë nëse përfshinin ndonjë rast të gjuhës së urrejtjes në titujt e lajmeve, e që ndoshta ka nxitur gjuhën e urrejtjes. Në lajmet e postuara gjuha e urrejtjes shfaqet nëpërmjet komenteve paragjyuese ndaj një grupi njerëzish, stereotipeve dhe citimeve të burimeve që përfshijnë vërejtje nënçmuese. Nga gjithsej 43,511 komente në titujt e lajmeve të postuara, 659 prej tyre i referoheshin ose rikrijonin përmbajtje të gjuhës së urrejtjes. Mund të themi se kjo i pasqyron dy gjëra, se gjuha e urrejtjes është :a) jashtëzakonisht e rrallë në postimet e lajmeve; dhe b) se gjuha e urrejtjes shpesh provokohet jo vetëm nga tema që diskutohet, por edhe nga komentet në komentet e lexuesve në fillin e debatit. E shprehur në përqindje, i bie që 22% janë komente me gjuhë të urrejtjes kur titujt e lajmeve përmbajnë gjuhë apo shprehje të urrejtjes, ndërsa 78% janë komente me gjuhë të urrejtjes kur titujt e lajmeve nuk përmbajnë gjuhë të urrejtjes.




Figura 15. Përqindja e komenteve e klasifikuar sipas vlerësimit nëse postimi i lajmit përmban ose jo gjuhë të urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes ndaj personave LGBTI: diskursi në media sociale

Siç u tha më sipër, debati parlamentar i zhvilluar në seancën e datës 16 mars 2022, lidhur me miratimin në lexim të parë të Kodit Civil, dhe disa nga qëndrimet politike të shprehura nga deputetët e Kuvendit në kontekst specifik kanë shkaktuar dhe nxitur reagime dhe komente homofobike në mediat sociale nga përdoruesit e mediave sociale. Në analizë janë gjetur më shumë se 700 komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes. Ky është numri më i lartë i komenteve nga nëntë datat e analizuar në periudhën dyvjeçare. Nuk është për t'u habitur që seksualiteti është kategoria dominuese (25% e komenteve të gjuhës së urrejtjes) dhe ndryshimi midis këtyre gjetjeve dhe gjetjeve nga 8 datat e tjera të marra në konsideratë është i habitshëm. Një rritje e konsiderueshme e komenteve të klasifikuara si "mallkim" shfaqet gjithashtu menjëherë pas datës 16 mars 2022.




Figura 16. Numri i shprehjeve të përdorura në periudhën dyvjeçare

Në mediat online shqipfolëse, ky ishte i vetmi rast ku u gjetën komente të gjuhës së urrejtjes lidhur me fenë (d.m.th. fjala muxhahidat për t'iu referuar muxhahidëve ose talebanëve).

Një gjuhë që përmbante gjuhë urrejtjeje dhe mallkime për të tjerët është evidentuar në komentet e qytetarëve në lajmet e publikuara nga mediat më 16 mars 2022 dhe që kishin temë martesat e të njëjtit seks.

Çështja e Veriut dhe marrëdhëniet ndëretnike: Diskursi në mediat sociale

Një periudhë tjetër interesante për t'u analizuar ishte edhe tetori i vitit 2021, kur në Kuvend u diskutua çështja e Veriut (shtrirja e legjitimitetit të shtetit të Kosovës në komunat veriore). Ky diskutim shkaktoi disa komente etnike si nga komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb, dhe veçanërisht në faqen e Facebook-ut të mediumit online në gjuhën serbe, "ku rreth 20% e komenteve të gjuhës së urrejtjes kishin të bënin me marrëdhëniet ndëretnike. Shumica e këtyre komenteve të gjuhës së urrejtjes përmbanin terma nënçmues për shqiptarët e Kosovës.




Figura 17. Komentet e gjuhës së urrejtjes në mediat online lidhur me përkatësinë etnike

Ndryshe nga vrojtimi i gjuhës së urrejtjes për përkatësinë etnike që shihen në faqet e Facebook-ut të mediave online shqipfolëse, ku mbiemra nënçmues për serbët përdoren edhe nga personat e përkatësisë etnike shqiptare kur synonin të ofendonin një person tjetër nga i njëjti grup etnik, kjo nuk është gjetur në faqet e Facebook-ut të medias online serbisht-folëse, ku komentet e gjuhës së urrejtjes me konotacion etnik kanë për qëllim vetëm shqiptarët.

TË GJETURAT

Të gjeturat e hulumtimit përkitazi me monitorimin e seancave parlamentare të Kuvendit të Kosovës

Avokati i Popullit, nga monitorimi i 9 seancave parlamentare në Kuvendin e Kosovës, brenda periudhës kohore janar 2020 – mars 2022, gjen se nuk është hasur nxitje e drejtpërdrejtë e urrejtjes. Megjithatë, në këto seanca parlamentare është hasur në shprehje tjera të gjuhës së përdorur, ajo që tek të gjeturat e këtij raporti është vlerësuar si gjuhë e butë e urrejtjes. Po ashtu, Avokati i Popullit gjen se rastet e gjuhës së urrejtjes që janë hasur në analizimin e seancave parlamentare, nuk thonë thjesht se dikush duhet të urrehet, por ofron mbështetje të urrejtjes së supozuar diskriminuese. Pra, gjuha e urrejtjes nuk manifestohet domosdoshmërisht përmes shprehjeve të urrejtjes, por mund të fshihet në deklaratat që në shikim të parë mund të duken të arsyeshme ose normale.

Të gjeturat nga monitorimi i mediave dhe ndikimi në gjuhën e përdorur nga ndjekësit në rrjetin social

Nga monitorimi i 23 emisioneve të debateve televizive të transmetuara edhe në mediet online, në tri medime të ndryshme¹³³, dhe nga komentet që ato kanë gjeneruar nga ndjekësit në rrjetet sociale Avokati i Popullit gjen se gjuha e urrejtjes është mjaft e shprehur. Avokati i Popullit thekson se komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve tjera nuk janë vetëm rezultat i komenteve tjera në transmetimin e drejtpërdrejtë të debatit në Facebook, ato lidhen drejtpërdrejt me temën që debatohet nga të ftuarit në emisionet e debatit televiziv.

Po ashtu, bazuar në emrat e përdoruesve dhe fotot e profilit në Facebook, marrë parasysh se profilet nuk janë vërtetuar sa i përket përcaktimit të gjinisë dhe faktin nëse profilet ishin të rreme apo të vërteta, hulumtimi gjen se 86% e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve tjera, janë postuar nga burrat, ndërsa 9.3% e tyre janë postuar nga femrat, përderisa 5% e profileve nuk u identifikuan. Ndërsa, sa i përket shënjestrave se kë synonin në mënyrë specifike komentet me gjuhën e urrejtjes, hulumtimi gjen se tendenca më e madhe e këtyre komenteve synonin kryesisht personat publikë, (liderë politikë, politikanë në përgjithësi, apo analistë të ftuar në debate televizive). Në përgjithësi, gjuha e urrejtjes synon persona të caktuar në 8 nga 10 raste dhe grupe njerëzish në 3 nga 10 raste.

Sa i përket relevancës sasiore brenda korpusit të të dhënave komentet më të numërta janë ato që synonin besimet politike, pasojnë komentet në lidhje me profesionet dhe tiparet morale të konotuara negativisht të kategorizuara si të tjera, pastaj aftësinë e kufizuar, metaforat çnjerëzore, përkatësia etnike, seksualiteti, mallkimin dhe besimin fetar.

Po ashtu nëse në debatet televizive përdoret gjuhë ashpër/papërshtatshme, shikuesit kanë më shumë gjasa të postojnë komente urrejtjeje në faqet e Facebook-ut, kur debati transmetohet drejtpërdrejt. Ndërsa, kur në debatin televiziv temë kryesore ishte diskutimi në seancë parlamentare i datës 16 mars 2022, lidhur me Projektkodin Civil (ky diskutim parlamentar ishte tema kryesore në debatin televiziv

¹³³ 17 janë mbledhur përmes faqeve të emisioneve në Facebook, ku janë transmetuar drejtpërdrejt, ndërsa 6 janë mbledhur nga kanalet televizive në YouTube. Mostra përfshinte edhe një emision televiziv në gjuhën serbe, "Slobodno Srpski", por nuk është hasur në komente në faqen e emisionit në Facebook për datat e përzgjedhura.

Debat Plus, ndërsa në *Pressing* nuk është debatuar, dhe *Rubikon*, nuk u transmetua në atë datë), komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes lidhur me temën e debatit në këtë emision në shumicën e rasteve kishin të bënin me gjininë dhe orientimin seksual. Shumica e komenteve iu drejtuan mysafirëve të debateve televizive që ishin në favor të modifikimit të Kodit Civil dhe përmbanin raste të gjuhës me përmbajtje të emrave me konotacione pezhorative.

Të gjeturat lidhur me gjuhën e përdorur në platformat e mediave sociale

Për të eksploruar shembuj të komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në platformat e mediave sociale, janë mbledhur komentet nga faqet në Facebook të katër mediave online, - "Gazeta Express", "Telegrafi", "IndeksOnline", dhe "Kosovo Online". Përzgjedhja e këtyre katër mediave online, është bërë në bazë të numrit të ndjekësve.

Hulumtimi gjen se një(1) koment në çdo pesëmbëdhjetë(15) komente përmban gjuhë të urrejtjes. Shumica e komenteve hyjnë në tri kategori: metafora çnjerezore, bindje politike dhe aftësi të kufizuara. Ka pasur komente në të cilat përdoruesit kanë përdorur metafora të lidhura me kafshët, metaforat bimore, etj. Bindjet politike dhe aftësia e kufizuar janë në shënjestër të barabartë dhe gjerësisht Seksualiteti dhe përkatësia etnike janë shënjeshtruar shpesh, ndërsa mallkimi ose feja mezi mund të kategorizohen. Gjuha e urrejtjes në lidhje me seksualitetin është gjetur në 10% të komenteve. Kjo e dhënë ishte veçanërisht e dukshme në komentet pas seancës parlamentare të 16 marsit 2022, kur u diskutua për çështjen e martesave të të njëjtit seks. Në përgjithësi, komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes synonin persona të caktuar në 6 nga 10 raste dhe grupe njerëzish në 3 nga 10 raste.

Nëse krahasojmë faqet (portalet) e përzgjedhura të katër mediave online në Facebook, vërehet një ndryshim i dukshëm në objektivat e komenteve të faqes në facebook të mediumit online në gjuhën serbe në krahasim me tri portalet e tjera. Në portalin në gjuhën serbe, pothuajse 40% e komenteve synonin një grup, që është pothuajse dyfishi në krahasim me shifrat e treguara nga analiza e 3 mediave në shqip. Ky rezultat mund të shpjegohet me faktin se tema kryesore e komenteve në faqen e Facebook-ut të mediumit në gjuhën serbe ka të bëjë me marrëdhëniet etnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Numri më i madh i komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes e që si jkategorit dominuese ka seksualitetin është evidentuar në komentet e qytetarëve në lajmet nga mediat, më 16 mars 2022 që kishin temë martesat e të njëjtit seks. (25% e komenteve të gjuhës së urrejtjes).

Të gjeturat nga lidhur me diskutimet për çështjen e Veriut dhe marrëdhëniet ndëretnike

Kur në Kuvend u diskutua çështja e Veriut (shtrirja e legjitimitetit të shtetit të Kosovës në komunitat veriore- tetor 2021), reflektoi edhe në gjuhën e komenteve në faqet e Facebook-ut të mediave. U vërejtën disa komente etnike si nga komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb, dhe veçanërisht në faqen e Facebook-ut të mediumit online në gjuhën serbe, "ku rreth 20% e komenteve të gjuhës së urrejtjes kishin të bënin me marrëdhëniet ndëretnike. Shumica e këtyre komenteve të gjuhës së urrejtjes përmbanin terma nënçmues për shqiptarët e Kosovës.

Ndryshe nga vrojtimi i gjuhës së urrejtjes për përkatësinë etnike që shihen në faqet e Facebook-ut të mediave online shqipfolëse, ku mbiemra nënçmues për serbët përdorshin edhe nga personat e përkatësisë etnike shqiptare kur synonin të ofendonin një person tjetër nga i njëjti grup etnik, kjo nuk është gjetur në faqet e Facebook-ut të medias online serbisht-folëse, ku komentet e gjuhës së urrejtjes me konotacion etnik kanë për qëllim vetëm shqiptarët.

KONSTATIME

Avokati i Popullit, nga të gjeturat e këtij hulumtimi dhe bazuar në kërkesat që dalin nga *Rekomandimi CM/Rec(2022)161 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes*, vlerëson se duhet të punohet më shumë në iniciativat bashkëpunuese, të cilat duhet të përfshijnë më gjerësisht sektorin e tretë, duke përfshirë, institucionet e pavarura, OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile; organet profesionale; platformat e mediave sociale të cilat mund të kenë nevojë të sfidohen në mënyrë më efektive për angazhimin e tyre aktiv në tregjet dytësore, dhe duhet të synohet në luftimin më të mirë të gjuhës së urrejtjes dhe fenomeneve të krimit të urrejtjes duke përfunduar legjislacionin antidiskriminues, duke siguruar kod efektiv të sjelljes dhe duke nxitur parandalimin përmes fushatave solide të vazhdueshme ndërgjegjësuese në arsim, si dhe në sektorët publikë dhe të medias, duke konstatuar si në vijim:

Avokati i Popullit vëren se Kuvendi i Kosovës nuk e ka nxjerr Kodin e Sjelljes për deputet, siç kërkohet me Rregulloren Kuvendit të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit, konstaton se është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës të nxjerr Kodin e sjelljes së deputetve në mënyrë që të sanksionohet përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme, ofenduese, denigruese, poshtëruese dhe gjuhës së urrejtjes.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e tematikës dhe qasjen gjithpërfshirëse për ta parandaluar gjuhën e urrejtjes, si dhe nisur nga rëndësia e Lirisë së shprehjes dhe kufizimit të saj në ratset kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime, Avokati i Popullit vëren se është i domosdoshëm angazhimi i institucioneve edukative e arsimore në mënyrë që të krijohen programe arsimore për nxënësit dhe studentët për të mësuar për pasoja e përdorimit të gjuhës së urrejtjes si në sektorin publik ashtu edhe privat. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të përdorimit të gjerë të mediave sociale dhe mungesës së të kuptuarit se veprimet dhe gjuha e përdorur në rrjetet social mund të jetë po aq e përgjegjshme sa edhe fizikisht. Me qëllim të edukimit mediatic të shoqërisë, është e rëndësishme që nxënësit të mësojnë për dhe rreth medias, si audiencë dhe si përdorues, duke përfshirë diversitetin, tolerancën shoqërore, jodiskriminimin në të gjitha nivelet e shkollimit.

Po ashtu, marrë parasysh kompleksitetin e tematikës dhe qasjen gjithpërfshirëse për ta parandaluar gjuhën e urrejtjes, si dhe rëndësinë e Lirisë së shprehjes dhe kufizimit të saj në ratset kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime, përcjella e jurisprudence për prokurorët dhe gjyqtarët të jenë në hap dhe të përcjellin zhvillimet në jurisprudencën e GjEDNj kur përballen me trajtimin (ndjekjen/mbrojtjen/gjykimin) e rasteve të krimeve të urrejtjes për të siguruar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit konstaton se në Programet trajnuese të Akademisë së Drejtësisë, nuk ka module të veçanta apo të përfshira në programin e trajnimit të vazhdueshëm që trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me këtë tematikë.

Avokati i Popullit vëren se gjuha e përdorur në debatet publike dhe ligjërime politike nga politikanët ndikon në masë të madhe te publiku i gjerë dhe se kjo e përcakton tematikën dhe tonin e diskursit publik. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishëm rolin aktiv dhe përgjegjësinë e Komisionit Qendror Zgjedhor, në mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, **në mënyrë që të respektohet në mënyrë specifike ndalimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes.**

Avokati i Popullit, për qarkun kohor që shqyrton ky raport, konstaton se mungon moderimi në media që ekspozojnë opinionin publik ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se KPM nuk ka treguar reagim në kohë reale në monitorimin e vazhdueshëm për gjuhën e urrejtjes. Avokati i Popullit e vlerëson të rëndësishëm angazhimin e KPM-së për fushata të vazhdueshme kundër gjuhës së urrejtjes duke përfshirë mënyrën se si mund të bëhen ankesat, si dhe të bashkëpunojë me media dhe gazetarë për parandalimin e gjuhën e urrejtjes dhe reagimit në kohë reale dhe të shpejtë kundër gjuhës së urrejtjes.

Avokati i Popullit vëren se publiku i gjerë duhet të jetë më i vetëdijshëm për pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe ndikimin e saj në shoqëri. Prandaj, Avokati i Popullit e vlerëson si shumë të rëndësishme që të gjitha shtyllat e pushtetit në vend të punojnë së bashku, duke përfshirë organizatat profesionale, si dhe organizatat joqeveritare për të rritur ndërgjegjësimin, për të identifikuar praktikatat më të mira, për të dënua aktet e gjuhës së urrejtjes ose krimin e urrejtjes dhe për të riafirmuar parimet e demokracisë, sundimit të ligjit, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Avokati i Popullit, e vlerëson si shumë të rëndësishëm edhe angazhimin e vazhdueshëm të Organeve Vetërregulluese si KMSHK-ja, në kuptim të fushatave për edukimin lidhur me ankesat në raport me gjuhën e urrejtjes, bashkpunimin me OShC për të mbështetur ankuesit për paraqitjen e ankesave kundër gjuhës së urrejtjes, të punojnë me organet e medias për të lejuar komentet në uebsajtin e tyre, por të kërkojë që ato të filtrojnë komente të tilla në vend që t'i ndalojnë ato krejtësisht. Mediat dhe platformat e mediave sociale duhet të angazhohen në rishikimin e kodeve të tyre të sjelljes për të nxitur moderimin e përmbajtjes dhe – kur është e nevojshme – për të hequr përmbajtjen me urrejtje, në krijimin e proceseve për ndjekjen e menjëhershme të ankesave të përdoruesve kur shënjohet përmbajtja e gjuhës së urrejtjes, duke mos lënë anash ofrimin e trajnimeve profesionale për gjuhën e urrejtjes për punonjësit e tyre, si dhe të lehtësojnë shpërndarjen e fushatave ndërgjegjësuere për të parandaluar gjuhën e urrejtjes.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Kuvendit të Republikës së Kosovës:

- Të nxjerr Kodin e sjelljes, siç parashihet me nenin 129 të Rregullorës së Kuvendit, me të cilin ndër të tjera do të përcaktojë vendosjen e masave ndaj deputetëve që nuk i përmbahen Kodit të sjelljes në raport me gjuhën e përdorur gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit, si dhe të krijojë një mekanizëm për hetimin e ankesave ndaj deputetëve që nuk i përmbahen Kodit të Sjelljes.

Qeverisë së Republikës së Kosovës:

- të hartojnë program të veçantë për publikun e gjerë në edukimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes dhe për pasojat e tyre
- përmes mekanizmave të saj të organizojë në vazhdimësi fushata vetëdijesuese për publikun e gjerë në edukimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes, sipas programit të hartuar.

Mministrisë së Arsimit Teknologjisë dhe Inovacionit;

- të zhvillojë një strategji kombëtare për edukimin mediatik në nivelin e shkollimit parauniversitar dhe universitar
- të përfshihet në kurrikulat shkollore Edukimi Mediatik në lëndët e detyrueshme në arsimin parauniversitar

Komisionit Qendror Zgjedhor

- Në pajtim me detyrimet ligjore të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të miratojë udhëzues për subjektet politike, me qëllim të parandalimit të gjuhës së urrejtjes,
- Të krijoj mekanizëm të brendshëm dhe efikas të monitorimit dhe mbikëqyrjes së respektimit të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në mënyrë specifike për ndalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes.
- Të harmonizojë përmbajtjen e formularit për regjistrimin e partive politike, një të siç është miratuar formulari për Çertifikimin e Subjekteve politike, kjo në pajtim me detyrimet e përcaktuara edhe në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në zbatim të kodit të mirësjelljes dhe ndalimit të gjuhës që nxit urrejtje dhe diskriminim.

Akademisë së Drejtësisë

- të përfshijë trajtimin e gjuhës së urrejtjes dhe praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së me përkitazi me këtë tematikë, në modul të veçantë në programin e trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të Republikës së Kosovës.

Odës së Avokatëve të Kosovës

- Të ofrojë trajnime për ndalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes si dhe të trajnohen për ndjekjen/mbrojtjen/gjykimin e rasteve të krimeve të urrejtjes në mënyrë që ata të jenë në gjendje të zbatojnë jurisprudencën e GjEDNj.

Komisionit të Pavarur për Media:

- të krijojë mekanizma për monitorimin dhe reagimin në kohë reale të medieve audio vizuele në vend, me qëllim të parandalimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes.
- të organizojë në vazhdimësi fushata vetëdijesuese për punëtorët e medieve dhe publikun e gjerë në edukimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*"Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj"*).

Bazuar në nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit *"Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"*, ju lutem të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me sa përmban ky Raport dhe Rekomandimet e adresuara.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

Ky raport u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, përmes projektit “Lufta kundër diskriminimit dhe urrejtjes”, që është pjesë e programit të përbashkët “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.